

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5620  
E hënë, 5 nëntor 2018  
çmimi 0.40 €

## Së shpejti pritet të hiqen provizionet për pagesat në POS



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### PO VAZHDON ÇARJA E LISIT NGA PYKA E VET

F. 12



Sylejman KRASNIQI

#### GJUHA KROATE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

F. 6

#### SËMUNDJET NGJITËSE PREKIN MBI 100 MIJË PERSONA NË VIT

F. 5

#### MINISTRI ISMAILI ZOTOHET PËR TRANSFORMIMIN E PLOTË TË SHËNDETËSISË

F. 7

### EKONOMI

#### PEZULLOHET PUNA NË MBI 30 VENDPUNISHTE

F. 9

### KULTURË



#### KONGRESI I MANASTIRIT DHE MOTRAT QIRIAZI

F. 16

Safete ROGOVA

### SPORT

#### JAVA E MYSAFIRËVE NË FUTBOLL

F. 16

#### LORIANA DHE AKILI, TË ARTË NË HUNGARI

F. 16



#### KOSOVA PRET QË BASHKIMI EVROPIAN (BE) TA MBAJË PREMTIMIN PËR VIZA PASI JANË PËRMBUSHUR TË GJITHA KRITERET PËR KËTË PROCES

IFAQE 3

## Hoxhaj: Nëse BE-ja ka hezitim për vizat, pse atëherë t'i besojmë për dialogun me Serbinë

Zyrtarët e lartë shtetërorë kanë kritikuar hezitimin e disa shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) në lidhje me vendimmarrjen rreth liberalizimit të vizave për Kosovën. Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë të dielën se nëse sot ka hezitim nga disa kryeqytete të BE-së në lidhje me vendimmarrjen në këtë proces, atëherë pse duhet që Kosova t'i besojë këtij institucioni në dialogun me Serbinë. Hoxhaj ka thënë se Kosova në këtë proces është angazhuar dhe ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe, sipas tij, BE-ja ka premtuar lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës me përmbushjen e këtyre kriterëve

FLET PËR "EPOKËN E RE", IZMI ZEKA



## Zgjedhjet e brendshme do ta reformojnë PDK-në

Anëtari i Këshillit Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Izmi Zeqa, ka thënë se zgjedhjet e brendshme do ta mobilizojnë edhe më shumë këtë subjekt politik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se në kuadër të këtij procesi zgjedhor do të ndodhin edhe reforma për pastrimin e partisë nga individë që gjithçka brenda subjektit politik e shikojnë në relacion me interesin e vet personal. Zeqa ka theksuar se PDK-ja është në një fazë kur kërkohet të krijohet struktura partiake me njerëz dhe kuadro të cilët qëllimi i përfitimeve nuk vjen në konsideratë dhe as nuk konsiderohet i pranueshëm për partinë.

## Partitë politike ende shpresojnë për arritjen e konsensusit për dialogun

IFAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijibiznesi.com](http://www.kolegijibiznesi.com)  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Të dielën është votuar për Këshillin Nacional në Luginën e Preshevës

**PRESHEVË, 4 NËNTOR** - Të dielën në Luginën e Preshevës janë mbajtur zgjedhjet e Këshillit Nacional të Shqiptarëve, i cili merret ekskluzivisht me çështjet e shqiptarëve atje, me qël-

lim të avancimit të të drejtave të shqiptarëve në fushën e arsimit, kulturës dhe përdorimit të simboleve kombëtare.

Njohës të së drejtës

kushtetuese në Kosovë thonë se të drejtat e shqiptarëve atje janë përkeqësuar dhe se ata që marrin mandatin për udhëheqjen e Këshillit duhet të jenë unik dhe t'i përparojnë të drejt-

tat e tyre nacionale.

Janë gjashtë shqiptarë nga parti të ndryshme të cilët pretendojnë të udhëheqin me Këshillin Nacional Shqiptar në Serbi.



## Presidenti tregoi dinjitet, kryeministri respekton kreun e Shtetit

Me mosdekretimin e Sandër Lleshit presidenti Ilir Meta tregoi se kryetari i Shtetit nuk është korrier apo noter-korrier i kryeministrit. Kushtetuta thotë që kryeministri propozon dhe dekretin e ka presidenti, pasi në të kundërt do të shkruhej se kryeministri e çon thjesht për vule në sekretarinë e Presidencës

**TIRANË, 4 NËNTOR** - Të dielën kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ngjiti me hap të shpejtë shkallët për te zyra e presidentit të Republikës. Natyrisht mosdekretimi i emrit Sandër Lleshi e bëri të dalë këtë të diele nga shtëpia. Të dielën kryeministri Rama ia kushton Zahos, si një baba i devotshëm, aq sa asnjëri nuk guxon ta shqetësojë në fundjavë. Por kësaj radhe Rama ishte herët në zyrë dhe i kërkoi takim presidentit. Takimi u mbajt, megjullja sikur u largua disi për t'i lënë vendin fillimjavës së re, mundet prapë me një takim dakortësie institucionale.

Presidenti ndërmori veprimin me dinjitoz për emrin e kryetarit të Shtetit, ndonëse hamendjet shkojnë në limite të paimagjueshme. Dinjiteti i kryetarit të shtetit është dinjitet për çdo nënshtetas, ndaj veprimi i tij ishte për t'u përshëndetur në respekt të institucionit kushtetues dhe si përfaqësues i popullit. Por duhet pranuar se edhe kërkesa e kryeministrit Rama për të shikuar mundësinë e një zgjidhje, prapë ka nevojë për vlerësim.

Në fund të fundit me këtë veprim mosdekretimi Ilir Meta tregoi se kryetari i Shtetit nuk është korrier apo noter-korrier i

kryeministrit. Kushtetuta thotë që kryeministri propozon dhe dekretin e ka presidenti, pasi në të kundërt do të shkruhej se kryeministri e çon thjesht për vule në sekretarinë e Presidencës!

Fakti që kanë ndenjur 90 minuta Meta dhe Rama në Presidencë nuk mendohet se Sandër Lleshi është diskutuar apo debatuar 90 minuta. Burime nga kryeministria tregojnë se biseda ka pasur një paketë çështjesh. Paketa si fjalë nuk ka vetëm një emër apo një çështje, por nënkupton disa çështje. Burimi brenda Kryeministrisë thotë se mund të jenë biseduar çështje si SHISH,



KLSH, ambasadorët, etj. Meta-Rama u takuan në fundjavë dhe duket një dritë e re për javën që po vjen vullshëm. Por ish-drejtori i Shërbimit

Informativ Ushtrisë (SHIU), Ylli Zyla thotë se kjo ishte loje shahu e Edi Ramës, pasi nuk e donte Sander Lleshin, sepse ka në mendje një emër tjetër.

## Basha paraqet planin për dekriminalizimin e zgjedhjeve



**TIRANË, 4 NËNTOR**-Kryetari i Partisë Demokratike (PD) Lulzim Basha ka nisur të dielën një bashkëbisedim me qytetarët në Korçë për platformën e PD-së për çlirimin e zgjedhjeve, të ekonomisë dhe të politikës nga krimi.

"Ju e dini se më shumë se gjysma e parave që janë investuar këtu në Korçë, kanë shkuar në xhepat e kontraktorëve, që janë përdorur thjesht për t'i zhvatur këto para dhe futur në xhepat e tyre dhe të politikanëve. Është

fakt se në pjesën tjetër të vendit nuk ka pasur asnjë investim domethënës, as rritje rrogash e pensionesh. Është fakt se nuk ka një investim të huaj të rëndësishëm në këto 5 vjet", tha Basha.

"Sot nuk jam këtu për të gërvishur këtë plagë, por për të prezantuar themelet e planit tonë për zgjidhjen e këtij problemi. Ne kemi paraqitur tri shtyllat për pastrimin e politikës nga krimi, çlirimin e zgjedhjeve. Nuk ka qytet më të mirë për ta

nisur këtë se nga Korça dhe do ta vazhdojmë në mbarë vendin. Ato janë baza e veprimit që do të ndryshojnë situatën në Shqipëri. Përtej denoncimeve, përtej dhënies zë të zemërimit popullit, sot opozita, PD-ja po paraqet rrugët e daljes nga kriza. Jo thjesht me slogane, por me platforma konkrete", tha Basha, duke ia lënë fjalën deputetëve të PD-së: Jorida Tabaku, Oerd Bylykbashi dhe Gazmend Bardhi, që shpjeguan këtë platformë.

## Fushatë për njohjen në Kushtetutën e Maqedonisë si "shqiptarë"

**SHKUP, 4 NËNTOR** - Shqiptarët në Maqedoni nisën një fushatë në rrjetet sociale, me qëllim që t'i ndërgjegjësojnë politikanët që të njihen si shtet-formues, teksa vendi po punon për ndryshimet kushtetuese, në

bazë të Marrëveshjes së Prespës.

Në qendër të fushatës "Don't you 20% me, I'm Albanian" (Mos më quaj 20%, unë jam shqiptar), janë kërkesat për partitë politike që të japin kon-

tributin e tyre dhe që përmes amendamenteve të propozojnë në Parlament ndryshimin në kushtetutë të emërimit "bashkësia etnike mbi 20%", të cilin e quajnë term fyes, dhe zëvendësimin e tij me

emërtesën "shqiptarët".

Fushata në Facebook gjithashtu synon edhe në zëvendësimin në pjesët ku thuhet "gjuha e bashkësisë etnike mbi 20%" dhe në vend të saj të jetë "gjuha shqipe".



# ta reformojnë PDK-në

kandidat, mirëpo do të kujdesem që të bartë në strukturat e partisë një frymë të mirë dhe një kolegialitet që konsideroj se do t'i ndihmoj partisë për ruajtjen e vlerave të kontributdhënësve që nga fitimi i lirisë dhe në të gjitha proceset e shtetndërtimit. Procesi i kandidaturave është transparent. Unë nuk do të kanalizoj promovimin e ndonjë ideje në parti, por do të përkrah çdo kandidaturë që del sipas një procesi legal dhe mbi bazën e meritokracisë. "Dekada e re" në vete ngërthen edhe nevojën për ndryshime dhe kjo jep një energji pozitive për fuqizimin e PDK-së.

**"Epoka e re":** Sa do ta ketë të vështirë PDK-ja për ta rikthyer qeverisjen në Gjilan?

**Zeka:** Është e vërtetë se elektorati ka lëvizur në drejtime të ndryshme në aspektin e rreshtimit politik, në të njëjtën kohë besoj se e vetmja parti e cila është në gjendje dhe ka kapacitet intelektual dhe moral për të avancuar dhe për të çuar përpara procese të rëndësishme dhe procese komplekse kapitale si në komuna dhe në nivel vendi është PDK-ja. Oponentët politikë kanë pasur kohë për laboratorët e tyre të shpifjeve dhe trillimeve kundër nesh. Gjithashtu, edhe disa media dhe rrjete sociale përmes "fake news" dhe të tjerët që iu kanë besuar, dhe kjo realisht ka ndikuar në votuesin tonë. Por, është me rëndësi që ne si parti dhe si shoqëri mos të kultivojmë arrogancë politike dhe se gara politike të ketë kufijtë e vet. Pushtetet janë të ndara dhe nuk duhet që partitë politike t'i bëjnë gjyqin askujt e aq më pak llojit të vet (partisë tjetër politike), sepse kjo krijon standard të cilin do ta vuajmë në të ardhmen, siç edhe po ndodh. Faza në të cilën gjendemi si komunë është më se e nevojshme për qytetarin që ta ketë zërin e vet drejtpërdrejt me qeverisjen e PDK-së.

**"Epoka e re":** Si është gjendja në terren e PDK-së, sepse kohët e fundit kanë dalë sondazhe ku PDK-ja radhitet partia e tretë pas LDK-së dhe LV-së. Ka ndikuar kjo për shkak se PDK-ja ka një kohë që është në pushtet?

**Zeka:** Siç e thashë, ne si parti kemi qenë të përkushtuar në shtetndërtim, ndërsa të tjerët (jo të gjithë) në të kundërtën, dhe se ka krijuar mundësi që qytetari të mos ketë informata të drejtë dhe reale në

kohën e duhur. PDK-ja në tërësinë e vet dhe PDK-ja në Gjilan ka shtrirje në të gjithë territorin si dhe ka funksionale degët dhe strukturën. Sondazhet në vendin tonë jo gjithnjë kanë treguar realitetin nga terreni, por nëse i marrim të mirëqena, ne tash veç jemi në fazë të zgjedhjeve dhe se freskia në parti besoj se përmes një mobilizimi, edhe elektorat, do të ketë një reflektim real nga qytetari.

**"Epoka e re":** A mendoni se z. Veseli duhet të jetë kandidati i vetëm për kryetar të partisë edhe për një mandat?

**Zeka:** Kandidimi është i hapur për secilin, por unë besoj se z. Veseli tash për tash është kandidatura më kredibile dhe veçse është fitues i një palë zgjedhjeve kombëtare. Pra, nuk ka asnjë arsye të mendohet për ndërrimin e liderit kur shihet një elan dhe përkushtim

për punë të mirë.

**"Epoka e re":** Pas përfundimit të procesit zgjedhor në parti, çfarë prisni nga udhëheqja e re?

**Zeka:** Pres energji të re e cila do të duhet të punojë për fitoren e PDK-së, e cila gjithsesi do t'i përshpejtojë proceset e avancimit dhe prosperimit të shtetit të Kosovës në rrafshin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar.

## Sëmundjet ngjitëse prekin mbi 100 mijë persona në vit

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kosova vazhdon të jetë vend endemik për sëmundje ngjitëse. Këto sëmundje shpesh manifestohen edhe në forma të rënda dhe përballja me to është mjaft sfiduese, derisa ka raste kur vdekshmëria është e pashmangshme. Kështu ka thënë Sali Ahmeti, infektolog, sipas të cilit, disa prej sëmundjeve ngjitëse janë të reja për Kosovën. "Këto sëmundje që kanë ardhur në Kosovë janë si rezultat i hapjes së dyerve me botën e jashtme dhe si rrjedhojë jemi të prekur edhe nga shumë sëmundje ngjitëse e që konsiderohen si të reja, por që rrezikojnë jetën e njeriut dhe janë të kushtueshme", ka thënë Ahmeti.

Gjatë një viti, sipas të dhënave aktuale, infektohen me sëmundje ngjitëse rreth 100 mijë persona. Sipas zyrtarëve shëndetësorë, numri i të prekurve nga sëmundjet ngjitëse është rreth 6 000 raste për 100 mijë banorë. Këto shifra i ka dhënë Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë.

Doktor Sali Ahmeti specifikon sëmundje ngjitëse që janë paraqitur në Kosovë e që konsiderohen si të reja për vendin. "Për herë të parë në dhjetëvjetorin e fundit kemi pasur forma të malaries, që persona që kanë ardhur nga bota e jashtme e

kanë sjellë sëmundjen, pastaj ka qenë virusi i Nilit perëndimor. Pra, këto janë sëmundje ngjitëse të reja, e që jemi ballafaquar me to. Pastaj gjatë kësaj vere dhe në dy vjetët e kaluara jemi ballafaquar me rotavirus e që janë një problematikë e veçantë e sëmundjeve si dhe sallmonella e shumë të tjera. Ende vazhdojmë të kemi shfaqje të etheve hemorragjike e pa diskutim edhe forma endemike. Pastaj është bruceleza, tularemia. Në vitin e kaluar kemi pasur shpërthim epidemik të morbillit, parotitit etj", ka thënë Ahmeti.

Bazuar në një studim të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe institucioneve të tjera, në vitet e fundit sëmundja e fruthit është rishfaqur në Evropë, ku numri i njerëzve të infektuar që nga viti 2007 është trefishuar. Fruthi është një sëmundje ngjitëse dhe serioze e shkaktuar nga një virus që përhapet nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë dhe përmes ajrit.

Ky virus mund të përhapet shpejt, sidomos në ato vende ku vaksinimi është nën shifrat 95 për qind të popullsisë. Vitin e kaluar për periudhën gjashtëmujore kur edhe ishin lajmëruar rastet e para të fruthit në Kosovë, viti është përmbyllur me 1 005 persona të prekur me

këtë virus, ku prej tyre 552 janë hospitalizuar në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Në anën tjetër, Lul Raka, mikrobiolog, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se shkalla e vdekshmërisë nga sëmundjet ngjitëse është e lartë. "Sëmundjet ngjitëse përcillen me shkallë të konsiderueshme të vdekshmërisë, por këto sëmundje kanë edhe kosto të lartë dhe e marrin një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të shtetit", ka thënë Raka.

Nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë gjatë vitit 2016, sipas Entit të Statistikave, janë shënuar 64 raste të vdekjeve, e që ky vit është i fundit që ky institucion ka nxjerrë statistika në fjalë.

Një ndër faktorët që ka ndikuar që disa sëmundje ngjitëse të zvogëlohen, por edhe të zhduken në Kosovë, është vaksinimi. Kosova renditet në mesin e shteteve më të suksesshme në botë sa i përket imunizimit, kanë thënë drejtues të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë. Me një mbulueshmëri me mbi 95 për qind të imunizimit të fëmijëve në Kosovë, e që realizohet në kuadër të Programit të Zgjeruar të Imunizimit, ky program konsiderohet një prej ngjarjeve më të suksesshme të shëndetësisë së Kosovës.



subjekteve politike në Kosovë ka profile të njerëzve me ambicie korruptive, që gjithçka brenda subjektit politik e shikojnë në relacion me interesin e vet personal. Ndaj kryetari Veseli, duke iu referuar kësaj kategorie "aktivistësh", ka proklamuar reformat në kuadër të së cilës do të jetë edhe beteja për pastrimin e partisë nga individë të tillë. Tani jemi në një fazë kur kërkohet që të krijojmë struktura partiake me njerëz dhe kuadro të cilët qëllimi i përfitimit nuk vjen në konsideratë dhe as nuk konsiderohet i pranueshëm për partinë.

**"Epoka e re":** Në Gjilan kush do të jetë kandidati për kryetar dege të PDK-së? Do të jeni ju?

**Zeka:** Jo, unë nuk do të jem

Flet për "Epokën e re", Izmi Zeka

# Zgjedhjet e brendshme do



Anëtari i Këshillit Drejtues i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Izmi Zeka, ka thënë se zgjedhjet e brendshme do ta mobilizojnë edhe më shumë këtë subjekt politik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se në kuadër të këtij procesi zgjedhor do të ndodhin edhe reforma për pastrimin e partisë nga individë që gjithçka brenda subjektit politik e shikojnë në relacion me interesin e vet personal. Zeka ka theksuar se PDK-ja është në një fazë kur kërkohet të krijohet struktura partiake me njerëz dhe kuadro të cilët qëllimi i përfitimeve nuk vjen në konsideratë dhe as nuk konsiderohet i pranueshëm për partinë. Ai ka thënë se Kadri Veseli tash për tash është kandidatura më kredibile për të vazhduar drejtimin e PDK-së

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Anëtari i Këshillit Drejtues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Izmi Zeka, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka folur për procesin e brendshëm zgjedhor. Ai ka theksuar

se në kuadër të këtij procesi zgjedhor do të ndodhin edhe reforma në pastrimin e partisë nga individë që gjithçka brenda subjektit politik e shikojnë në relacion me interesin e vet personal. Zeka ka thënë se e vetmja parti e cila është në gjendje dhe ka kapacitet intelektual dhe moral për të avancuar dhe për

të çuar përpara procese të rëndësishme dhe procese komplekse kapitale si në komuna ashtu edhe në nivel vendi është PDK-ja. Zeka ka bërë me dije se PDK-ja është në një fazë kur kërkohet të krijohet struktura partiake me njerëz dhe kuadro tek të cilët qëllimi i përfitimeve nuk vjen në konsideratë dhe as

nuk konsiderohet i pranueshëm për partinë. Ai ka thënë se Kadri Veseli tash për tash është kandidatura më kredibile për ta vazhduar drejtimin e PDK-së. "Nuk ka asnjë arsye të mendohet për ndërrimin e liderit", është shprehur Zeka.

**"Epoka e re":** Z. Zeka, PDK-ja ka hapur zgjedhjet e brendshme, ku pritet të dalë udhëheqja e re e partisë. Çfarë do të thonë këto zgjedhje kësaj here për PDK-në?

**Zeka:** Këto zgjedhje, përveç në aspektin statutor që përcaktojnë obligimin për një proces zgjedhor si formë e demokracisë për themelimin e strukturave politike të partisë, në aspektin politik dhe strategjik nënkuptojnë një rior-

ganizim me njerëz të ri, të zgjedhur në forumet e partisë, të cilët janë në gjendje ta vazhdojnë rrugën e forcimit të PDK-së, duke bartur mbi vete procese të rëndësishme politike të vendit. Pra, gjithsesi ka edhe rol mobilizues.

**"Epoka e re":** Z. Veseli ka përcjellë mesazh se në PDK nuk do të kenë vend ata që mendojnë vetëm për përfitime. Ka pasur të tillë në PDK?

**Zeka:** Po, kështu ka thënë, ndonëse është fakt i njohur se në PDK gjithmonë ka pasur njerëz që me kontributin e tyre kanë dëshmuar që nuk e kanë primar interesin individual para atij shtetëror. Mirëpo, në anën tjetër, ne jemi të vetëdijshëm se brenda të gjitha

# ta reformojnë PDK-në

kandidat, mirëpo do të kujdesem që të bartë në strukturat e partisë një frymë të mirë dhe një kolegialitet që konsideroj se do t'i ndihmoj partisë për ruajtjen e vlerave të kontributdhënësve që nga fitimi i lirisë dhe në të gjitha proceset e shtetndërtimit. Procesi i kandidaturave është transparent. Unë nuk do të kanalizoj promovimin e ndonjë ideje në parti, por do të përkrah çdo kandidaturë që del sipas një procesi legal dhe mbi bazën e meritokracisë. "Dekada e re" në vete ngërthen edhe nevojën për ndryshime dhe kjo jep një energji pozitive për fuqizimin e PDK-së.

**"Epoka e re":** Sa do ta ketë të vështirë PDK-ja për ta rikthyer qeverisjen në Gjilan?

**Zeka:** Është e vërtetë se elektorati ka lëvizur në drejtime të ndryshme në aspektin e rreshtimit politik, në të njëjtën kohë besoj se e vetmja parti e cila është në gjendje dhe ka kapacitet intelektual dhe moral për të avancuar dhe për të çuar përpara procese të rëndësishme dhe procese komplekse kapitale si në komuna dhe në nivel vendi është PDK-ja. Oponentët politikë kanë pasur kohë për laboratorët e tyre të shpifjeve dhe trillimeve kundër nesh. Gjithashtu, edhe disa media dhe rrjete sociale përmes "fake news" dhe të tjerët që iu kanë besuar, dhe kjo realisht ka ndikuar në votuesin tonë. Por, është me rëndësi që ne si parti dhe si shoqëri mos të kultivojmë arrogancë politike dhe se gara politike të ketë kufijtë e vet. Pushtetet janë të ndara dhe nuk duhet që partitë politike t'i bëjnë gjyqin askujt e aq më pak llojit të vet (partisë tjetër politike), sepse kjo krijon standard të cilin do ta vuajmë në të ardhmen, siç edhe po ndodh. Faza në të cilën gjendemi si komunë është më se e nevojshme për qytetarin që ta ketë zërin e vet drejtpërdrejt me qeverisjen e PDK-së.

**"Epoka e re":** Si është gjendja në terren e PDK-së, sepse kohët e fundit kanë dalë sondazhe ku PDK-ja radhitet partia e tretë pas LDK-së dhe LV-së. Ka ndikuar kjo për shkak se PDK-ja ka një kohë që është në pushtet?

**Zeka:** Siç e thashë, ne si parti kemi qenë të përkushtuar në shtetndërtim, ndërsa të tjerët (jo të gjithë) në të kundërtën, dhe se ka krijuar mundësi që qytetari të mos ketë informata të drejtë dhe reale në

kohën e duhur. PDK-ja në tërësinë e vet dhe PDK-ja në Gjilan ka shtrirje në të gjithë territorin si dhe ka funksionale degët dhe strukturën. Sondazhet në vendin tonë jo gjithnjë kanë treguar realitetin nga terreni, por nëse i marrim të mirëqena, ne tash veç jemi në fazë të zgjedhjeve dhe se freskia në parti besoj se përmes një mobilizimi, edhe elektorat, do të ketë një reflektim real nga qytetari.

**"Epoka e re":** A mendoni se z. Veseli duhet të jetë kandidati i vetëm për kryetar të partisë edhe për një mandat?

**Zeka:** Kandidimi është i hapur për secilin, por unë besoj se z. Veseli tash për tash është kandidatura më kredibile dhe veçse është fitues i një palë zgjedhjeve kombëtare. Pra, nuk ka asnjë arsye të mendohet për ndërrimin e liderit kur shihet një elan dhe përkushtim

për punë të mirë.

**"Epoka e re":** Pas përfundimit të procesit zgjedhor në parti, çfarë prisni nga udhëheqja e re?

**Zeka:** Pres energji të re e cila do të duhet të punojë për fitoren e PDK-së, e cila gjithsesi do t'i përshpejtojë proceset e avancimit dhe prosperimit të shtetit të Kosovës në rrafshin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar.

## Sëmundjet ngjitëse prekin mbi 100 mijë persona në vit

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kosova vazhdon të jetë vend endemik për sëmundje ngjitëse. Këto sëmundje shpesh manifestohen edhe në forma të rënda dhe përballja me to është mjaft sfiduese, derisa ka raste kur vdekshmëria është e pashmangshme. Kështu ka thënë Sali Ahmeti, infektolog, sipas të cilit, disa prej sëmundjeve ngjitëse janë të reja për Kosovën. "Këto sëmundje që kanë ardhur në Kosovë janë si rezultat i hapjes së dyerve me botën e jashtme dhe si rrjedhojë jemi të prekur edhe nga shumë sëmundje ngjitëse e që konsiderohen si të reja, por që rrezikojnë jetën e njeriut dhe janë të kushtueshme", ka thënë Ahmeti.

Gjatë një viti, sipas të dhënave aktuale, infektohen me sëmundje ngjitëse rreth 100 mijë persona. Sipas zyrtarëve shëndetësorë, numri i të prekurve nga sëmundjet ngjitëse është rreth 6 000 raste për 100 mijë banorë. Këto shifra i ka dhënë Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë.

Doktor Sali Ahmeti specifikon sëmundje ngjitëse që janë paraqitur në Kosovë e që konsiderohen si të reja për vendin. "Për herë të parë në dhjetëvjetorin e fundit kemi pasur forma të malaries, që persona që kanë ardhur nga bota e jashtme e

kanë sjellë sëmundjen, pastaj ka qenë virusi i Nilit perëndimor. Pra, këto janë sëmundje ngjitëse të reja, e që jemi ballafaquar me to. Pastaj gjatë kësaj vere dhe në dy vjetët e kaluara jemi ballafaquar me rotavirus e që janë një problematikë e veçantë e sëmundjeve si dhe sallmonella e shumë të tjera. Ende vazhdojmë të kemi shfaqje të etheve hemorragjike e pa diskutim edhe forma endemike. Pastaj është bruceloza, tularemia. Në vitin e kaluar kemi pasur shpërthim epidemik të morbillit, parotitit etj", ka thënë Ahmeti.

Bazuar në një studim të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe institucioneve të tjera, në vitet e fundit sëmundja e fruthit është rishfaqur në Evropë, ku numri i njerëzve të infektuar që nga viti 2007 është trefishuar. Fruthi është një sëmundje ngjitëse dhe serioze e shkaktuar nga një virus që përhapet nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë dhe përmes ajrit.

Ky virus mund të përhapet shpejt, sidomos në ato vende ku vaksinimi është nën shifrat 95 për qind të popullsisë. Vitin e kaluar për periudhën gjashtëmujore kur edhe ishin lajmëruar rastet e para të fruthit në Kosovë, viti është përmbyllur me 1 005 persona të prekur me

këtë virus, ku prej tyre 552 janë hospitalizuar në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Në anën tjetër, Lul Raka, mikrobiolog, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se shkalla e vdekshmërisë nga sëmundjet ngjitëse është e lartë. "Sëmundjet ngjitëse përcillen me shkallë të konsiderueshme të vdekshmërisë, por këto sëmundje kanë edhe kosto të lartë dhe e marrin një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të shtetit", ka thënë Raka.

Nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë gjatë vitit 2016, sipas Entit të Statistikave, janë shënuar 64 raste të vdekjeve, e që ky vit është i fundit që ky institucion ka nxjerrë statistika në fjalë.

Një ndër faktorët që ka ndikuar që disa sëmundje ngjitëse të zvogëlohen, por edhe të zhduken në Kosovë, është vaksinimi. Kosova renditet në mesin e shteteve më të suksesshme në botë sa i përket imunizimit, kanë thënë drejtues të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë. Me një mbulueshmëri me mbi 95 për qind të imunizimit të fëmijëve në Kosovë, e që realizohet në kuadër të Programit të Zgjeruar të Imunizimit, ky program konsiderohet një prej ngjarjeve më të suksesshme të shëndetësisë së Kosovës.



subjekteve politike në Kosovë ka profile të njerëzve me ambicie korruptive, që gjithçka brenda subjektit politik e shikojnë në relacion me interesin e vet personal. Ndaj kryetari Veseli, duke iu referuar kësaj kategorie "aktivistësh", ka proklamuar reformat në kuadër të së cilës do të jetë edhe beteja për pastrimin e partisë nga individë të tillë. Tani jemi në një fazë kur kërkohet që të krijojmë struktura partiake me njerëz dhe quadro të cilët qëllimi i përfitimeve nuk vjen në konsideratë dhe as nuk konsiderohet i pranueshëm për partinë.

**"Epoka e re":** Në Gjilan kush do të jetë kandidati për kryetar dege të PDK-së? Do të jeni ju?

**Zeka:** Jo, unë nuk do të jem

# Panairi 'Studioni në Francë' njofton studentët me mundësitë e studimit në universitetet franceze

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka bërë hapjen e panairit "Studioni në Francë", organizuar në bashkëpunim me Ambasadën e Francës në Kosovë dhe Aleancën Franceze në Prishtinë. Në këtë panair ishin të pranishëm dhjetëra universitete dhe institucione franceze, të cilat i informuan studentët lidhur me mundësitë e studimit në Francë në programet e studimit në gjuhën frënge dhe atë angleze, në nivelet bachelor, master dhe doktoratë.

Hapjen e këtij panairi e ka përshëndetur edhe rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Marjan Dema. Ai ka thënë që UP-ja është shumë i interesuar për lidhjen e bashkëpunimit me botën frankofone dhe është duke shënuar progres në këtë drejtim. "UP-ja ka kohë që ia ka hapur dyert frankofonisë. Ne e kemi shënuar hapin e parë në këtë

drejtim me hapjen e Qendrës Universitare Frankofone në kuadër të universitetit tonë, rreth një vit më parë. Që nga themelimi QUF-ja ka organizuar disa aktivitete frankofone, nga të cilat kanë përfituar 345 studentë dhe pjesëtarë të stafit akademik të universitetit, teksa jemi anëtarësuar edhe në Agjencinë Universitare Frankofone", ka thënë Dema. Ai ka shtuar se menaxhmenti i UP-së është shumë i interesuar të krijojë bashkëpunim me institucione të edukimit të lartë, të cilat kanë për qëllim shkëmbimin e përvojave, teksa i ka ftuar studentët të përfitojnë nga mundësia e dhënë për studim në Francë. Ai, po ashtu, ka përgëzuar stafin për realizimin e suksesshëm të këtij panairi.

Ndërsa Cecile Fistberg, udhëheqëse e bashkëpunimit në Ambasadën Franceze në Kosovë, ka pohuar se ky panair i organizuar për informim të studimeve në Francë ka për qëllim që studentëve t'u mundësohet të jenë në kontakt me



universitete, me qëllim që t'i shohin mundësitë e studimeve atje.

Edhe drejtori i Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani", Fazli Gajraku, i ka ftuar studentët dhe stafin akademik t'i shfrytëzojnë

mundësitë që jep ky panair, në mënyrë që të krijojnë kontakte me institucione arsimore në Francë. Edicioni i parë i Panairit të Edukimit "Studioni në Francë" ka për qëllim prezantimin e institucioneve të edukimit të lartë nga

Republika e Francës para studentëve, të diplomuarve dhe stafit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për të krijuar mundësi studimi dhe shkëmbimi të përvojave akademike.

## Gjuha kroate në Universitetin e Prishtinës



PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Sot (e hënë) në orën 12:00 në sallën e Amfiteatrit të Fakultetit të Filologjisë (afër dekanatit) fillon kursi Gjuhë kroate 1 me profesoreshën nga Universiteti i Zagrebit, prof. Ivan?ica Bankovi?-Mandi?.

Në hapje të këtij kursi do të marrë pjesë edhe ambasadorja e Republikës së Kroacisë në Republikën e Kosovës, Marija Kapitanovic, ndërkaq nikoqire

e saj do të jetë dekanja e Fakultetit të Filologjisë, prof. Linditë Sejdiu Rugova. Sipas një njoftimi të Ambasadës së Kroacisë në Kosovë, bëhet me dije se një çast i tillë shënon një kthesë të rëndësishme të bashkëpunimit ndërkademi ndërmjet të dyja institucioneve meqë edhe nga marsi 2019 në Universitetin e Zagrebit do të fillojë të mbahet kursi i

shqipes për nevoja të gjuhësisë nga profesorët e Departamentit të Gjuhës Shqipe nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". "Këto iniciativa do të çojnë drejt forcimit të iniciativës së përbashkët për formimin e një lektorati të përhershëm të kroatishes në Prishtinë dhe të shqipes në Zagreb", është theksuar në njoftimin e Ambasadës së Kroacisë.

## Pastrohet qyteza e bukur e Janjevës

JANJEVË, 4 NËNTOR (ER) - Dhjetëra vullnetarë, banorë e zyrtarë komunalë, i janë bashkuar aksionit të dielës në Janjevë, ku janë larguar dhjetëra thasë me mbeturina përgjatë brezit rrugor si dhe pesë kamionë me mbetje të përziera nga një deponi e madhe. Ky aksion u realizua në kuadër të fushatës "Ta pastrojmë Kosovën". Besnik Shabiu nga "Let's Do It Kosova" ka bërë me dije se në kuadër të kësaj fushate deri më tani janë pastruar 350 deponi ilegale të mbeturinave në gjithë Kosovën. "Fatkeqësisht, numri i deponive ilegale në Kosovë është mjaft i madh, mirëpo në çastet që

ne po flasim themi se mbi 350 deponi ilegale janë eliminuar në gjithë Kosovën prejse ka filluar fushata. Po shihet një interesim i madh i gjithë komunave që t'i qasen aksionit të pastrimit dhe kur të gjithë e marrin me përgjegjësi, si aktorët institucionalë, ashtu edhe qytetarët, po besoj se deri më 15 dhjetor fundi i deponive ilegale do të vijë shumë shpejt", ka thënë Shabiu. Ai ka treguar se në Komunën e Istogut ka filluar edhe trajnimi i mësimdhënësve, i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në fushën e mjedisit jetësor.



# Partitë politike ende shpresojnë në arritjen e konsensusit për dialogun

Ndonëse javën e kaluar ka dështuar miratimi i rezolutës së opozitës, ende ka shpresë për arritjen e konsensusit në mes të partive politike për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përfaqësuesit e subjekteve në pushtet dhe atyre në opozitë kanë bërë me dije se do t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për arritjen e një uniteti për këtë çështje. Edhe njohësit e proceseve politike dhe monitoruesit e punës së Kuvendit u kanë bërë thirrje partive të fokusohen në pikat e përbashkëta dhe në bazë të tyre të nxjerrin një rezolutë të re të Kuvendit për dialogun

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Pavarësisht prej mosmiratimit të rezolutës së opozitës për dialogun, partitë politike nuk kanë hequr dorë nga përpjekjet për ta arritur konsensusin politik për procesin e dialogut me Serbinë.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ishin të interesuara të dështojë rezoluta e kësaj të fundit për dialog me Serbinë. Ai ka deklaruar se opozita nuk ishte e interesuar të ketë pajtim me pozitën për këtë çështje. Sipas Nitajt, partitë e koalicionit qeverisës ishin të gatshme ta plotësonin me propozime këtë rezolutë, por një gjë e tillë u refuzua nga opozita pa ndonjë arsye. Nitaj ka treguar se pozita nuk do të ndalet së kërkuar konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. "Besoj se nuk do të rreshtin përpjekjet për konsensus. Por, sa i përket ekipit, unë nuk e kuptoj pse Qeveria kërkon votim në kuvend. Ajo e ka mandatin ta caktojë ekipin vetë. Ajo duhet të ketë kujdes që marrëveshjen ta bëjë të atilël që të marrë dy të tretat e votave, se ekipi nuk është punë e Kuvendit. Platforma po", ka vlerësuar Nitaj, duke shtuar se nëse nuk arrihet konsensusi,

dikush tjetër do të vendosë për këtë çështje. "Nëse nuk arrihet konsensusi, kam frikë se dikush tjetër do të vendosë për këtë çështje. Bota nuk po ka kohë të merret me hajgarexhi. Ne ka vite që nuk funksionojmë pa shtytjen e të tjerëve. Po duket se një pjesë e jona votojmë, qoftë edhe për interes të vendit, vetëm kur s'kemi qare. Qeveria e kryeministri janë seriozë në këtë temë, por Kuvendi duhet ta marrë rolin e vet", është shprehur Nitaj për gazetën "Epoka e re".

Edhe shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka deklaruar se pozita dhe opozita duhet të gjejnë një konsensus për fazën finale të dialogut me Serbinë, pastaj të flasin për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se fakti që ende nuk është arritur një marrëveshje në mes të pozitës dhe opozitës për të ashtuquajturën fazë të fundit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk është një lajm i mirë. Megjithatë, Sherifi ka shprehur optimizëm që së shpejti pozita dhe opozita do të arrijnë të gjejnë një mënyrë për t'u bërë bashkë për këtë çështje. "Aktualisht kemi një situatë ku dy partitë opozitare, LDK-ja dhe LV-ja, kanë dalë me kërkesën për zgjedhje para dialogut përderisa ne mendojmë se renditja duhet të jetë ndryshe, së pari dialogu, pastaj zgjedhjet. Kjo tash për tash e bën më të vështirë arritjen e një konsensusi. Megjithatë, shpre-



soj që së shpejti pozita dhe opozita do të arrijnë të gjejnë një mënyrë për t'u bërë bashkë për këtë çështje e cila shkon përtej interesave partiake", ka thënë Sherifi për gazetën "Epoka e re".

Ai ka deklaruar se do të ishte mirë që të mos shkohet në fazën përfundimtare të dialogut pa konsensus në mes të pozitës dhe opozitës. "Nuk mendoj se do të ishte mirë që të hyjmë në proces pa e arritur konsensusin e gjerë në mes të partive të pozitës dhe të opozitës", është shprehur Sherifi. Përveç deputetëve të pozitës, thirrje për arritjen e konsensusit kanë bërë edhe deputetët e taborit opozitar. Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka bërë thirrje që të lihen anash inatet partiake sepse pozita dhe opozita e kanë obligim mbrojt-

jen e Republikës. Sipas tij, subjektet politike duhet të bashkohen dhe ta ndërtojnë platformën për dialogun dhe ekipin negociator. "Më shumë se kurrë kemi nevojë për bashkim të forcave për mbrojtje të vendit. T'i lëmë anash inatet partiake sepse pozitë e opozitë e kemi obligim mbrojtjen e Republikës. Të bashkohemi dhe ta ndërtojmë platformën për dialogun dhe ta zgjedhim bashkërisht ekipin negociator. Ta ndalim Hashim Thaçin sa nuk është bërë vonë", ka shkruar Molliqaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe menaxheri i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës, Artan Murati, i ka ftuar subjektet politike në pozitë dhe opozitë që të fokusohen në pikat e përbashkëta dhe në bazë të tyre të nxjerrin një rezolutë të re të

Kuvendit për dialogun. Sipas tij, dialogu duhet t'i kthehet Kuvendit dhe Kuvendi të ketë rol qendror në këtë proces. "Në vazhdimësi KDI-ja bën thirrje për konsensus në mes të subjekteve politike, ofron rekomandime të ndryshme, si dhe shpeshherë ofron platforma për diskutim në mes të subjekteve politike. U bëjmë thirrje subjekteve politike që të fokusohen në pikat e përbashkëta dhe në bazë të tyre të nxjerrin një rezolutë të re të Kuvendit për dialogun. Bëjmë thirrje që dialogu t'i kthehet Kuvendit dhe Kuvendi të ketë rol qendror në këtë proces. Duhet të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia e procesit në mënyrë që deputetët të dinë se çfarë po ndodh në Bruksel dhe të dinë se për çfarë marrëveshje eventuale do të votojnë", ka deklaruar Murati për gazetën "Epoka e re".



## Ministri Ismaili zotohet për transformimin e plotë të shëndetësisë

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka premtuar se do të angazhohet çdo ditë deri në transformimin e plotë të shëndetësisë.

"Buzëqeshjet në fytyrat e personelit mjekësor tregojnë gjithçka. Shtretër të rinj edhe për Klinikën e Gjinekologjisë nga kontingjenti prej 750 shtretërve që

kemi blerë për Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK). Asnjë nënë dhe asnjë fëmijë nuk duhet të qëndrojë më në shtretër mbi blloqe e që

rrezikojnë shëndetin e tyre. Çdo ditë në punë deri në transformimin e shëndetësisë", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".



# SË SHPEJTI PRITET TË HIQEN PROVIZIONET PËR PAGESAT NË POS

Në Kosovë aktualisht janë 12 668 POS terminale (Point of Sale) të cilët janë të vendosura pranë arkave në dyqane dhe qendra të mëdha tregtare, mirëpo qytetarët hezitojnë të paguajnë me kartelë për shkak se nuk kanë njohuri sa i përket ndaljes së provizioneve, kurse as për bizneset nuk është e leverdishme kjo mënyrë e pagesës për shkak të ndaljes së provizioneve. Përfaqësues të Shoqatës së Bankave dhe Bankës Qendrore të Kosovës kanë bërë me dije për "Epokën e re" se së shpejti pritet të hiqen provizionet dhe të bëhet unifikimi për POS

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Në Kosovë aktualisht janë 12 668 POS terminale (Point of Sale) të cilët janë të vendosur pranë arkave në dyqane dhe qendra të mëdha tregtare. Nga gjithsejtë dhjetë banka që operojnë në Kosovë që kanë licencë, shtatë prej këtyre bankave e kanë rrjetin e tyre të terminaleve POS. Ndërkaq shuma që u ndalet provizion qytetarëve me rastin e pagesës është 10 deri në 20 për qind të vlerës së mallit në rast se ata bëjnë

pagesë në POS-in e ndonjë banke tjetër, kurse për POS-in e bankës së njëjtë nuk ka provizione. Mirëpo mungesa e informimit të qytetarëve, se çfarë shumë mund t'u ndalet në rast të pagesës me kartelë, ka bërë që shumë qytetarë të ngurrojnë të paguajnë me kartelë, duke preferuar pagesën me para të gatshme. Edhe për afaristët ndalja e provizioneve nga bankat ka bërë që ta largojnë këtë sistem të pagesës.

Në lidhje me këtë, zëdhënësi i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Kushtrim Ahmeti, ka theksuar për gazetën "Epoka e re" se sipas raportit të fundit të publikuar nga BQK-ja, në fund të muajit shtator të këtij viti në Kosovë janë 12 668 POS terminale. "Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në baza të rregullta mujore publikon të dhëna për statistikën e pagesave në Kosovë ku përfshihen edhe të dhënat për numrin e terminaleve për pagesa (POS). Sipas raportit të fundit të publikuar, në fund të muajit shtator të vitit 2018 në Kosovë kanë qenë 12 668 POS terminale", ka deklaruar Ahmeti.

I pyetur se cilat banka kanë POS të tyre, në mënyrë që qytetarëve mos t'u ndalën provizione, Ahmeti ka thënë se nga dhjetë banka që operojnë në Kosovë, shtatë prej tyre kanë rrjetin e tyre të termi-

naleve për pagesa POS. "Sa i përket tarifave për pagesat me kartelë duhet t'u referoheni çmimoreve të bankave për shërbimet e tyre, të cilat, sipas rregullores për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpallje, bankat janë të obliguara t'i publikojnë në uebfaqet e tyre dhe t'i përditësojnë rregullisht", ka deklaruar ai.

Ahmeti ka theksuar se BQK-ja me mbështetje edhe të Bankës Botërore është duke analizuar opsionet më të mira rreth mundësisë së unifikimit të rrjetit të terminaleve me pagesë POS si dhe pagesave me kartelë në përgjithësi.

Sipas statistikave mbi numrin e llogarive të klientëve të BQK-së, sa i përket pagesave me "e-banking" nga gjithsejtë 235 311 pagesa, nga të cilat individuale janë 193 524, kurse të bizneseve 41 787 apo shprehur në përqindje 11.83 për qind e përbëjnë individët të pjesëmarrjes të llogarive me qasje në internet në numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse, kurse vetëm afaristët 2.55 për qind.

Sa i përket terminaleve për pagesa POS dhe transaksionet sipas tipit të terminaleve, shprehur numerikisht janë 909 779 sosh në vlerë 32 498 088.12.

Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija, ka thënë për gazetën





"Epoka e re" se provizionet për pagesa në POS sillen nga 10 deri në 20 për qind në rast se bëhen në POS të bankës tjetër. "Provizionet sillen nga 10 deri në 20 për qind të vlerës së mallit të blerë në rast se bën pagesë në POS të bankës tjetër dhe në rast se banka juaj e ka POS-in e saj atëherë ka zero provizion", ka thënë Balija, duke shtuar se janë në diskutime që të bëhet një unifikim i POS-it për t'u hequr tërësisht POS. "Për datën se kur mund të bëhet ky unifikim momentalisht s'mund ta themi sepse jemi në diskutime", është shprehur ai.

Ndërkaq afaristi Burim Piraj ka pohuar për gazetën "Epoka e re" se ka vendosur që mos të përdorë POS për shkak se fitimet janë të vogla dhe një përqindje për këtë shërbim po ua marrin bankat. "Në firmën paraardhëse kemi pas POS në përdorim dhe kemi qenë të pakënaqur me përqindjen që duhej paguar. Në pikat e reja të fast-foodeve që kemi hapur nuk kemi qenë të gatshëm të instalojmë terminale për pagesa POS. Fitimet në Kosovë janë shumë të vogla dhe një përqindje të mirë po e merr banka, prandaj për ne ka mbetur opsioni i vetëm pagesa me të gatshme", është shprehur Piraj, duke shtuar se pagesat me kartelë janë një prej metodave më të përsosura. "Për

vendin tonë pagesat elektronike do të kishin bërë një revolucion në eliminimin e ekonomisë gri dhe rritjes së të hyrave në buxhetin e shtetit", ka thënë Piraj.

Arkëtarë A. Krasniqi, i cili punon në një nga supermarketet në Prishtinë, ka thënë se ka hezitime të qytetarëve për të paguar me kartelë për shkak të mosnjohurive të mjaftueshme. Ndërkaq një qytetar nga Prishtina, P. Salihu, ka treguar se më parë ka paguar me kartelë, edhe pse nuk ka qenë në dijeni se sa mund t'i ndalë banka provizion. "Më parë kam paguar me kartelë, mirëpo në janar të këtij viti nuk kisha pasur para në bankë dhe më është dashur të paguaj në një nga marketet tona në vlerë 2.62 centë. Unë llogarinë e kam në Bankën Kombëtare Tregtare dhe nuk kam qenë i njoftuar se mund të bëjë pagesa me minus, mandej më është bllokuar llogaria për një kohë dhe më janë ndaluar dy herë mjetet. Kam shkuar në bankë dhe ata më kanë kërkuar falje. Kjo procedurë më ka marrë kohë, andaj për shkak të këtyre telasheve hezitoj të paguaj me kartelë", ka thënë ky qytetar për gazetën "Epoka e re". Gazeta ka provuar të marrë përgjigje edhe nga përfaqësuesit e BKT-së, mirëpo kontakti me këtë bankë ka qenë i pamundur.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përmes Inspektoratit të Punës (IP) me plan operativ në ndërtimtari

# Pezullohet puna në mbi 30 vendpunishte

Për dy javë në Komunën e Prishtinës, gjatë inspektimit të rreth 160 vendpunishteve, janë shqiptuar 14 gjoba dhe janë ndërprerë punimet me masën e pezullimit të përkohshëm në 11 subjekte

PRISHTINË, 4 NËNTOR (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përmes Inspektoratit të Punës (IP), në vazhdim të angazhimeve dhe masave të ndërmarra për rritjen e sigurisë dhe shëndetit në punë, ka hartuar Planin Operativ për ngritjen e masave të sigurisë në vendet e punës, me theks në sektorin e ndërtimtarisë. Për dy javë në Komunën e Prishtinës, ku është më i përqendruar sektori i ndërtimtarisë, gjatë inspektimit të rreth 160 vendpunishteve janë shqiptuar 14 gjoba (ato subjekte të cilat nuk i kanë zbatuar vendimet e inspektorëve nga inspektimet e mëhershme) dhe janë ndërprerë punimet me masën e pezullimit të përkohshëm në 11 subjekte. Pas vizitave dhe analizave të planit operativ të zhvilluar përgjatë dy javëve të kaluara, MPMS

dhe IP kanë konstatuar se këto masa nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për ngritjen e masave të sigurisë, gjithmonë në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi. Duke pasur parasysh rastet e aksidenteve, lëndimeve dhe atyre me fatalitet, me kërkesë të ministrit të MPMS-së, Skender Reçica, për zbatim të pakompromis të legjislacionit në fuqi, inspektorati i Punës ka vazhduar riinspektimet në këtë sektor, duke kërkuar nga subjektet zbatim të plotë të masave të sigurisë (skeleton) dhe pajisje personale mbrojtëse, me ç'rast është pezulluar puna përkohësisht në mbi 30 vendpunishte të ndërtimit.

Qëllimi i vetëm i aktivitetit të përqendruar në sektorin e ndërtimtarisë është rritja e masave të sigurisë me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe jetëve të

punëtorëve. Për informim të qytetarëve dhe subjekteve që për veprimtari kanë sektorin e ndërtimit, ju njoftojmë se pezullimet e përkohshme të punës në vendpunishte nuk janë shoqëruar me gjoba. Subjekteve u është dhënë vendimi për pezullim të punëve deri në plotësimin e masave të sigurisë, gjoba pason në rastet kur shkelet ky vendim nga subjektet.

MPMS dhe IP u bëjnë thirrje të gjithë punëdhënësve që t'i respektojnë masat e përcaktuara me legjislacionin rreth sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në vendin e punës dhe njëherë të gjithë punëtorëve që t'i raportojnë rastet kur të drejtat e tyre nuk respektohen dhe shkelen nga punëdhënësit. MPMS-ja do të jetë e pakompromis për zbatimin e legjislacionit në fuqi.



## Kastrati e Shahini flasin për mundësinë e shkëmbimit të teksteve Kosovë - Shqipëri

DARDANË, 4 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Dardanës, Qëndron Kastrati, ka pritur në takim zëvendësministren e Arsimit të Shqipërisë, Besa Shahini. Kastrati bashkë me zëvendësministren Shahini kanë vizituar Gjimnazin "Ismail Qemali" në Dardanë dhe bashkë me stafin dhe nxënësit kanë shkëmbyer përvojat në aspektin e arsimit. Gjatë takimit është diskutuar për kurrikulën shkollore dhe për mundësitë e shkëmbimit të teksteve në mes të Kosovës dhe

Shqipërisë. Sipas kryetarit Kastrati, shkëmbimi i teksteve shkollore në mes të dy shteteve do t'i ndihmonte arsimit jashtëzakonisht shumë. "Gjithashtu, diskutuam për binjakëzimin e shkollave me mundësi që nxënësit të kryejnë një pjesë të shkollimit të mesëm në Shqipëri dhe Kosovë", ka thënë Kastrati. Ai ka thënë se takimet e këtij niveli do t'i bëjnë më të shpeshta, në mënyrë që të rritet bashkëpunimi në të gjitha fushat në mes të Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.



## Pas tetë vjetësh hasmëri, pajtohen familjet Hoti, Xani e Koca dhe familja Smajli

SKENDERAJ, 4 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka marrë pjesë në aktin e pajtimit në mes të familjeve Hoti, Xani e Koca nga Polaci dhe familjes Smajli nga Klina e Poshtme. Me këtë rast kryetari Jashari ka thënë se nga sot këto familje kanë lënë pas vetes të gjitha të këqijat, kanë shfaqur bindje se si shqiptarë respektojnë tolerancën dhe traditën dhe, para së gjithash, kanë treguar se e duan paqen dhe mirëbesimin. "Një akt më fisnik

dhe burrëror nuk ka mundur të bëhet ndryshe nga ai i sotmi me rastin e shtrirjes së dorës së pajtimit mes familjeve Hoti, Xani e Koca nga Polaci dhe familjes Smajli nga Klina e Poshtme. Isha i nderuar të jem i pranishëm në aktin e përfaqimit të burrave nga këto dy familje, pas tetë vjetëve në hasmëri, të cilat nga sot lanë pas vete të gjitha të këqijat dhe shfaqen bindje se si shqiptarë respektojmë tolerancën dhe traditën, dhe treguan se e duam paqen e mirëbesimin", ka thënë

Jashari. Ai ka bërë me dije se kontribut të jashtëzakonshëm për pajtimin e këtyre familjeve kanë dhënë: Zejnallah Prokshi, Murat Tahiri, Shyqeri Musliu dhe Shekip Fazliu. "Ky akt na kujton fillimin e pajtimit të gjaqueve nga i ndjeri Anton Çetta 28 vjet më parë. Ta kuptojmë e mos ta harrojmë faktin se liria dhe lumturia e një kombi nuk mund të jenë të plota pa qenë i lumtur vetë individi. Ju familje të nderuara, qofshi faqebardhë!", është shprehur Jashari.



## Vetëvendosje: Komuna e Lipjanit shpenzoi 8 000 euro për dreka zyrtare

LIPJAN, 4 NËNTOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se raporti nëntëmujor i shpenzimeve në Lipjan ka nxjerrë në pah mënyrën e shpenzimeve të parasë publike, mungesën e një buxheti zhvillimor dhe të mirëqenies, por edhe harxhimet e mëdha për dreka zyrtare. Sipas kësaj lëvizje, Komuna e Lipjanit nuk flet aspak për shfrytëzim racional të parasë publike. "Kur kanë mbetur vetëm edhe tre muaj deri në përfundim të vitit financiar, thuajse në secilën kategori ekonomike kur bëhet fjalë për shpenzimet për pasuritë jofinanciare apo investimet kapitale, vërehen shpenzime të ulëta të buxhetit të planifikuar. Kudo nëpër investimet kapitale, përqindja e shpenzimeve shkon pak mbi 50 për qind, ndërsa gjysma e buxhetit për investime ka mbetur e pashfrytëzuar, në një kohë kur nevojat e qytetarëve të



Komunës së Lipjanit janë të mëdha. Për më tepër, një qeverisje që për nëntë muaj ka shpenzuar vetëm 50 për qind të buxhetit për investime kapitale, e lë të hapur mundësinë që gjysma tjetër të harxhohet shkel e shko gjatë tre muajve të mbetur, pa vlerësim e planifikim të duhur dhe pa respektuar procedurat. Mbi 38 projekte të planifikuara masa e shpenzimeve është zero", është thënë në reagimin e Qendrës së Vetëvendosjes në Lipjan. Kjo lëvizje ka theksuar se vetëm për dreka zyrtare gjatë këtyre nëntë muajve janë shpenzuar rreth 8 000 euro, ndërsa për furnizim me pije dhe ushqim mbi 20 000 euro.

## Haziri kërkon dinamikë më të madhe nga drejtorët për realizimin e projekteve

GJILAN, 4 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, ku ishte i pranishëm edhe përfaqësuesi i programit USAID TEAM, ka diskutuar për përmblylljen më të mirë të mundshme të periudhës së mbetur të tremujorit të fundit të këtij viti në aspektin e punëve, realizimit të projekteve dhe pagesave. Në fjalën e tij, Haziri ka kërkuar nga drejtorët e drejtorive komunale që dinamikën e punëve ta ngrehin sikur që ka kërkuar bashkëpunim sipas natyrës së punës edhe të drejtorive mes vete, që shërbimi i nivelit lokal të jetë pranë kërkesave të qytetarëve dhe zgjidhjes së tyre. Ai ka kërkuar që për vitin

e ardhshëm të punohet së pari për përmblylljen e projekteve të filluara dhe të punohet në bazë të planifikimit të buxhetit edhe me investim të projekteve model të dëshkohet angazhim jo vetëm për investim, por edhe për mirëmbajtjen e tyre dhe ruajtjen. Haziri ka thënë se në sektorin e Shëndetësisë, Kadastrës dhe Bujqësisë tashmë është krijuar një stabilitet i plotë i shërbimeve për qytetarët, kurse nga drejtoritë e tjera ka kërkuar të jenë të harmonizuara mirë me Zyrën e Prokurimit, në mënyrë që të gjitha procedurat që nga inicimi e deri në finalizim të projektit të jenë të planifikuara mirë dhe të harmonizuara me

ligjet në fuqi. Ndërsa për fushën e arsimit që është prioritet i kësaj qeverisje, kryetari Haziri ka ofruar mbështetjen e plotë për të gjitha nismat që pikëprekin interesin e nxënëseve, mësimdhënëseve dhe prindërve. "Bashkëpunimi i Komunës së Gjilanit me donatorët dhe investitorët duhet të jetë në nivelin më të mirë të mundshëm, sikur që përgatitjet për investime duhet të jenë në aspektin profesional dhe në një kohë rekorde që ajo që është e mundur të fillohet këtë vit të bëhet me planifikim të qartë, kurse ajo që mbetet për vitin tjetër, sipas tij, të jetë e projektuar në bashkëpunim të plotë mes vete", ka thënë Haziri.

(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoui me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /13/

# Rifat Krasniqi para prokurorit:



**Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA**

(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)

Kur u pyet i pandehuri Rifat mbi akuzën që i bahet tha se: Unë veç emrit të vertet kam edhe një emër të fsheht "Sokrat- Skenderbeg". Unë të pandehurit Kajtaz Ramadanin nuk i kam dhanë leter e gjë. Ju tregua letra i cili u përgjigj e tha se kjo nuk është e vërtet dhe e mohoi tue shtuar se unë vetem në Prizren kam shkruar një letër me dorë e ja kam dhënë një mikut të Kajtazit.

Si u pyet prap e pandehuri Rifat tha se: i pandehuri Kajtaz me ka thënë ne katund kur une isha tue i vur në automobil per me ardhur ne Prizren, se ky është miku i tij dhe me i ba një letër per me ja que Jusuf Bardhit, dhe une kur kam ardhur këtu ne Prizren e kam shkruar une me flamurin, e per me ba ate më ka shtyr Kajtazi, tue e thanë me i shkruar dhe ia kam dhanë atij mikut qe me prezantoi. Kur unë kam qenë tue shkue në Prizren me ndërrue të hollat ka ndodhur kjo qe ky me ka ndal tek makina dhe me ka kerkue me i shkruar ku ishte bashk me ate mikun e vet, por une nuk u ndala, ky me tha se takoj në Prizren ke kaffja e Mustafa Mamushes. Ukë Sadikun e njof e me te nuk kam pas gjë dhe nuk i kamque drithë e gjë. Nuk është e vertet qe unë të kem dasht me i ardh ne ndihmë të arratisurve te malit. Nuk di nese komiteti ka que gjëra në mal. Komitetin e kemi formuar me fitua të drejtat tona me anën e qeverisë jugosllave per me na dhanë të drejtat e Flamurin tonë. A është takua Kajtazi me Ukën unë nuk e di. Neve skemi pas qëllim për kundra shtetit as me e ndihmue shokët në mal. Mbi pyetjen e bame të pandehurve nga ana e prokurorit, mbase betimit të bamun jemi takue një herë ne teqe dhe mbas dy ditëve tek Halili ne shtepi, muajin nuk e di por kjo ka ndodhur para se shkojn delegatët në Prishtinë. Neve mbi fjalën e Ahmet Dërgutit kemi biseduar ne teqe per Komitetin Demokratik Shqiptar e me kerkue Flamurin, nëpunës shqiptarë, e me u folë gjuha shqipe dhe kemi bisedue plotë pesë orë dhe mandej në shtëpin e Halilit. I pandehuri Kajtaz si u pyet tha se Rifati ka qenë gjyqëtar, Ahmet Dërguti intendent dhe unë kryetar i Këshillit të Frontit e të tjerë kanë qenë shqiptarë. Neve kemi bamun organizata të fshehta

dhe unë kam punuar që të jem Kryetar i Komitetit Demokratik dhe për këtë kam ba një gabim. Kur u pyet Rifat Krasniqi emnat "Sokrat dhe Skenderbeg" kanë qenë të mijat, une kam qenë sekretar i komitetit komunal ne katundin Mamush deri sa jam rreshtuar, unë jam gjyqëtar dhe 25 ditë më parë se të arrestohem me ka pas thirrë Xhavit Nimani per me me dhanë punë, unë kam qenë Sekretar i Komitetit Demokratik, Kajtazi kryetar e Ahmet Dërguti arkëtar. Neve kemi bamun dy mbledhje, të parën herë kemi qenë të mbledhur në Teqe dhe të dytën në shtëpin e Dërgutit. Mua me ka lajmruar herën e parë Kadri Minushi, shef i seksionit social në Rahovec se duhet te vish se kemi një bisedim, mandej ka ardhur edhe Kajtazi ne zyre dhe ky me ka thanë se a të ka thanë gjë Minushi, e mbasi unë i thash se ky me tha eja pra dhe ashtu kam shkue. Unë me asnjë njeri nuk kam fol për çështje politike.

### Kush ishte Ekrem Hado:


Ekrem Hadon e njohi qysh nga viti 1943 i cili ka qenë si kryetar i gjyqit në Prizren në atë kohë unë kam qenë si ndihmës gjyqëtar në Rahovec, seq drejtim politik ka pas ai nuk e di, por me sa di unë ai ka qenë kundra okupatorit, si me ka thënë një herë se kemi ba keq që skeni dal në mal me kohë para se të vijoshin partizanët këtu, dhe bile kur ka shkue Lefter Kristua me shokë në mal, ai ka thanë si nuk me lajmroi edhe mua. Në vitin 1944 jam fejuar me motrën e tij, këtë ndërmjtesi na i ka bamun zonja e shtëpisë ku ai rrinte. Nuk është e vërtet qe une udhëzimet ose mbushjen e mendjes ta kem prej Ekrem Hodos. Mua nuk me ka thënë kush per me hy në këtë punë por vetëm Kadri Minushi ma ka mbush mendjen e jo une atij. Dhe ai me ka thirr e kur kemi bisedue per punën e Shqipënisë dhe kur kemi ba betimin kemi pas një flamur me shqipe dhe jo me yll, kemi pas për qëllim me punue per me lidh Kosovën me Shqipërin, e kjo ka pas për qëllim ilegal me u bashkue. Komiteti ka caktua detyrat, e nga komiteti se kush nuk e di por bahet une ose Ahmeti qe ky ka thanë se duhet me u ba edhe komitete të tjera. Për radiostacion nuk di, por Vahit Mustafa me emër të fsheht "Flamur" me ka thënë se kemi një radio në Prizren. Dhe mohon lidhjet me Shqipëni e tjera, mohon rëzimin e qeverisë shqiptare dhe marrëdhëniet e shteteve te jashtme dhe thotë se janë krejt të padrejta, mohon edhe kryengritjen kryekëput. Haxhi Fasllin nuk e njohi, Ukë Sadikun e njohi i cili ndodhet në mal, per shkak se ashtë fajtor i madh dhe me te as kam folë, por bile me te kam armiqësi dhe s'kam pas tjetër, me kanë akuzu se i kam ndihmu të

arratisunit në mal, pse shprehet tue thanë kam qenë kundër atyre në mal dhe kam ndihmue LNÇ mohon lidhjet që ka pas komitetit. Nuk di për ndihmat e bame per komitetet. Komitetit ka qenë fillue ne prill kur une me 25 prill jam largue e kam heq dorë per ndihma nuk di kurrgjë, per kete them se munt ti dij arkëtari. Betimi asht bamun ne shtepin e Halil Dërgutit, i cili e ka pas per qellim me u mbajt e fshehur dhe kemi mar dhe emrat e fshehur, keta kanë qenë dhe ja me vra kend.

### Betimi para shokëve

Muharrem Bajraktarin nuk e njohi. Revolverin e kemi qit përmbi flamur e musaf kur bahesh betimi per me tremb e të mos dëftejn të fshehurat dhe kush dëften ka me u vra, aty ka qenë si thash dhe kurani dhe flamuri. Ky simbol, per zotin asht per me u tremb e mos me kallxue pse revolveri ska pas qëllim tjetër, vrasje e lufta s'kemi pas qëllim komiteti jonë ska pas lidhje as me Prizren por vetem kemi kujtue se do të ket ekzistue ndonji grindje. Në lidhje kemi qenë caktua une, Sheh Mujedini, Vahit Mustafa, e kemi ardh ketu ne Prizren pse Shehu tha se unë kam mik në Prizren, mbasi nuk mundem me gjetun jemi kthye pa ba mbledhje. Besoi se kjo organizat si e jona e fshehur nuk asht nga ato qe vjen ne kundërshtim me ligjet në veprim. Neve kemi pas mundesi me qenë lidhje, por mbas 20 ditëve ashtë prishur komiteti pse ky ka vazhdue afer 16 ditë. Një veper krimi te njo komiteti te mshefur si ky nuk formon krim se ska pas qëllim të keq. Me të vërtet kjo organizat ka qenë ilegale por ska pas qëllim me çduk pushtetin por me kerkue vetëm të drejtat, me gjithë që kemi pas emnin ilegal. Programi i parapar per me u lidhë me Shqipërin qe ekziston. 2. Populli te mos deshpohet per padrejtësinat që bahen, pse skemi pas flamur, kërkimin e nëpunësve shqiptar e të tjera. Organizata ilegale e formuar ska pas me veprue si intelektual me i fort aty se une une kam qen nga shokët me i mire por ashte e mundur qe Kadri Minushi e Kajtazi te me japin udhëzime mua. Sa di une e sa ka thanë Ahmet Dërguti e Kajtazi punen ma me randesi e ka pas Ahmeti per me marun emrin e zgjedhun anëtarët dhe ma i menqun se ne asht Kajtazi. Halim Spahin e njomi, vetem njihere jam takue me te kur ka qenë Kryetar i Këshillit Popullor të Prizrenit, per çështjen e një vëllait qe ka pas ushtar në Fier. Halim Spahija deklaronte: I pandehuri Halim Spahija kur u pyet rreth akuzës tha se " Unë emën të fshehun nuk kam, në kohën e okupacionit anmik unë skam pas pjesë në komitetin e lidhjes së dytë të Prizrenit, por jam marr me tregëti. Kam furnizue ushtar në

vitin 1941, e në fillim kam pas punue me emrin e firmes VLL. Spahija në Kukës, por jo vetem e kam pas me vone dhe shokët Esad Vehbija dhe të tjerët. Me Hasan remen kemi pas ortakit ne Kukës e ka pas vue një kapital ne doajen e Kukësit, e ky kishte te drejt sipas kapitalit ¼ e fitimit pse kishte vue kater pes herë ma pak. Nuk di mirë e ne vjetin 1927 apo 1937 nuk me kujtohet ashte bamun ortak me neve. Hasani ka pas per grue një çiken e një kushëri tonë dhe me kete skemi pas havale. Per rrymen politike të tij nuk di gjo, por kur ishte ketu e kam par qe mblidhte pare per partin komuniste per sasinat nuk e di. Me mua ndonji fjalë qe ka bamun por sa herë më asht drejtue e kerkue ndihma per partin komuniste i kam dhanë. Hasani gjithnji rrinte me shok të tij si me Tahir Dedën e të asaj moshe. Kam qenë si kryetar i Këshillit të Rrethit në Prizren deri në prillin qe shkoi qe kam shkue me leje në Tiranë, e familjen e kam pas lanë këtu ku e cila edhe sot ketu ndodhet. Me gjyqëtar Mborjen jam njoftu këtu në Prizren kur se jam kthyer nga Prishtina, me të cilin me ka njoftun Tahir Deda me parë se me prezantoi me than se asht një gjyqëtar nga Kukësi dhe se don me u taku me ju dhe kështu e ka e ka pru Tahiri në dyqan dhe mbasi eshte takue me mue me ka thanë se ishte i njoftur me A jahun ish Prokuror në Kukës, dhe ne biseduim e siper me pyeti se çka asht bamun ne Drenicë dhe unë i kam kallxue se Shaban Palluzha me do të tjerë me çeta kunder partizanve kanë fillue një luftë dhe me tha çka po te shoh keshtu një ftohësi, kjo ka qenë në fund të këtij viti, unë i kam tregue se pushteti ka me hetue e mund të dihet se nga ka rrjedhe, kete qe ate dite nuk e kam pare. Ky me ka pas pyet edhe se si u ba vrasja e hoxhes dhe me ka kerkue nese do të ishte e mundur me i diftue se sa janë vras, unë i kam thanë se keto unë nuk mund te ta nap dhe nese qeveria shqiptare mbasi me qeverin jugosllave eshte në gjendje të mirë duhet me i kerkue me anën e qeverisë mbasi ky me tha se i donte me i raportue gjendjen qeverisë shqiptare. Mbledhjet e shenimeve unë nuk i kam bamun as fjalë me te skisha me ja dhene dhe as nuk kemi mbetur me u takue me te në Kukës. Unë leje kisha kerkue në fruer e ne prill kam shkue në Tiranë dhe në mars kam ndermjetsuekur ndodhesha në Prishtinë per t'mu dhanë ;eja se në Tiranë me kishin shkruar se na kishin taksue me taksa të rendane dy dyqanet. Ne Tiranë kam qendre një muaj e mandej kam shkue në Kukës ne kontakt kam ra me njerëzit ne Tiranë si me Mehdi Elezin nga Dibra te cilin e kam pas njofto ne Prizren e ka marr



tesha ne dogaj e me ka kerkue një pjesë tjegullash. Politikisht me te skam bisedu gjë tjetër veç se si shkon ai tje. Mehdiu me pjesëtaret e familjes i kam par me petka zyrtare dhe nuk kam biseduar me te qe Enver Hoxha do te rrezohet e per Titon se nuk shkon shumë gjatë e se kane me u bamun nderime, keto nuk janë të vërteta. Hasan Rema ka qenë i burgosur prej Gestapos dhe e kanë lirue, kur e kanë burgosur kam qenë në Gjakovë dhe kur e kanë liruar jete kam qene ne Shkoder e kur e kam parë i kam fol pse në Shkoder me na thanë se e kanë rreshtue si partizan e kur u lirue ka veshur petkat e Gestapos. Hasani me Mehdi Elezin ka pas qenë njoftun per çështjen e Hasanit qe ka qenë veshur me uniforma gjermane si thashe ma sipër e kam pas ndie në Shkodër pse kishte pas ardh një herë prej Mitrovicesh shkue prap atje, te cilin kur e kam takue me ka thanë se kur e kishin lirue prej burgut eshte veshur me tesha dhe unë i kam folur se shumë keq e ka bamun por ai me tha se e kam ba vetem per me ardhe e me u pamun me familjen. Nuk e di nese ka ba ndonji sherbim okupatorit. Marrëdhëniet tregtare kam pas me te, e jo politike. Por qe ai asht veshur tregon puna se ka ba ndonji send gjermanve. Ky ka mbarue shkollen fillore, dhe nuk di se para luftes seç politik mbante e ashte intelijent din serbisht mirë dhe italisht. Rexhep Mborjen une njihere e kam takue. Mehdiu ka shkollte te nalt qe ka mesue jasht ne Itali ose në Francë. Tahir eshte burgosur per njehere me hasanin dhe janë lirue po bashk dhe per burgimin e dytë te tij nuk di gje se nuk kam qenë këtu, kete mund ta dij Tahiri qe ka ndejt gjithnji me të qysh nga Kukësi, më i zhdervjelll është Hasani nga keta të dy dmth. Tahiri. Szlejman Rizan e kam njofto dhe e kam shoqë e ka pas një rryme politike kofra okupatorit dhe ka ndejt ketu dhe ne Shqipëri, ka qenë para luftes ne Korqe si profesor, ky ka mbarue shkollë në Itali ose në Vjenë nuk e di ka ba një liber mbi gjuhën shqipe. (Vijon)



# KONGRESI I MANASTIRIT DHE MOTRAT QIRIAZI

Safete ROGOVA

Janë të rralla ngjarjet që shënuan një epokë, nismat që kurorëzuan një ideal, rrethanat që lindën një mrekulli. Kongresi i Manastirit gëzon epitetin e kryengjarjes që parapriu ndryshime në zhvillimet ballkanike e botërore. Shënon fillimin e fundit të një perandorie, shënon fundin e një durimi që do të shpërthejë në aspiratën e pafundme për liri e mëvetësi. Të shqiptarëve, fillimisht dhe, të popujve të tjerë në fqinjësi, lakmitarë deri në skajshmëri për ta marrë pjesën që nuk u takon.

Kongresi i Manastirit ishte një domosdo e kohës, kur tashmë ishin krijuar vatra diturie e arsimit, lëvizjeje e patriotizmi sa iluminist aq militant, të shumtën në kolonitë ku jetohej, veprohej e ëndërrohej për atë copë atdheu, mbetur në mëshirën e të huajve, në mëshirën e fatit, në mëshirën e kohës mes perëndimit e lindjes, mes dritës e errësirës.

Kolonitë e fuqishme dhe me shumë ndikim si ajo mu në zemër të Perandorisë Turke, në Stambollin e paradokseve, ku parakaluan shumë rilindës tanë, të të gjitha besimeve, pa përjashtim patën objektivin e parë dhe të fundit: një gjuhë, një shkrim dhe, mundësisht, sa më parë... se koha nuk priste. Koloni të tjera, klube të suksesshme gravituese atdhetarësh e kurbetarësh, me mallin e ngjeshur në trup e mendje, si ajo e Kairos, Aleksandrisë, Bukureshtit, Konstancës, Selanikut, Sofjes, Varnës, Barit, Brukselit, Londrës, Bostonit, Nju-Jorkut... e radha është e pafund, siç ishte sakrificat e pafund për t'u kurorëzuar përpjekjet për të dhënë një rezultat për të qenë.

Ai tashmë ishte në horizont, revolucionin i turqve të rinj tashmë kishte filluar, korriku dhe gushti i 1908-s kishte dhënë kushtetimin, ideatorët, përpos të tjerash ishin edhe intelektualët dhe atdhetarët shqiptarë, ishte vetë populli shqiptar. Ideatorët shpirtëror si Ibrahim Temo, një shqiptar i devotshëm dhe i pakompromis, Njazi Beu i Resnjës, njeri shumë i vendosur që me armë në dorë të ndryshojë historinë, gatisshmëria e më se 20.000 luftëtarëve kryengritës shqiptarë mbledhur në Ferizaj po ato ditë, shtrënguan perandorinë në dekompozim të premtionin 'diçka' në të mirë të shqiptarëve, një 'diçka' që do të shkrihej si kripa në ujë po të mos ishin në koherencë forcat më largpamëse intelektuale e militante dhe të më qenësishmes - vendosshmërisë së vet shqiptarëve.

Motoja e Kushtetutës, apo e Hyrjetit, "Bashkim dhe Përparim", sa ishte frymëzim, po aq qe një detyrim të themeloheshin në një periudhë shumë të shkurtër kohore klube të pagëzuara tashmë

si refleks të 'premtimeve' të turqve të rinj: klube "Bashkimi" dhe "Përparimi". Të tilla do të kishim tani pothuajse në çdo qytet shqiptar nga Shkodra deri në Selanik, nga Bukureshti deri në Kairo.

Por, njëri syresh, klubi "Bashkimi" i Manastirit, i formuar dhe i udhëhequr nga pinjollët e familjes Qiriazi dhe të intelektualëve dhe patriotëve shqiptarë pa dallim feje, si Fehim bej Zavalani, që bashkëvepruan në unison aq fuqishëm me Motrat Qiriazi, Sevastinë dhe Parashqevinë, sikundër edhe vëllanë e tyre, eruditin dhe patriotin Gjergj Qiriazi. Gjeratashmë ishte në përjetësinë divine, por fryma dhe vepra e tij bashkëjetonte me ideale të familjes, e shkollës së vashave, që nga viti 1891, e kombit që po përgatitej për ngjarjen më të madhe, e cila do ta shkëputte nga robëria për të ecur drejt lirisë, e cila nuk do të vononte, edhe pse gjysmak.

"Zëdhënia" e klubit shqiptar të Manastirit, e vendosur më 21 gusht 1908 dhe e proklamuar si ftesë e përgjithshme më 27 gusht, për të gjithë intelektualët dhe patriotët shqiptarë kudo që ata jetonin dhe vepronin, përfaqësues klubesh e instancash me ndikim për kurorëzimin e përpjekjes që shqiptarët të shkruajnë me një alfabet, një alfabet që do ishte urë rreshtimi me botën e qytetëruar. Një ftesë kjo, një detyrim ky që nuk mund ta refuzonte njeri!

Dhe një datë historike: Kongresi i Alfabetit do të fillonte më 14 nëntor, për të vazhduar deri më 22 nëntor, kur do të aprovohej një zgjidhje, le ta themi solomoniane, për të kënaqur polarizimet që vinin si refleksi i interesave meskine, apo dominim grupi të caktuar me një traditë, dorën në zemër të suksesshme, siç ishte ai përfaqësuesve të Alfabetit të Stambollit, por edhe i alfabeteve të shoqërive, po aq të njohura: "Agimi" dhe "Bashkimi" të Shkodrës, me përfaqësues të dinjitetshëm, nga më të dinjitetshmit: Dom Ndre Mjedën dhe At Gjergj Fishtën.

Suksesi i Kongresit ishte në radhë të parë sukses i një brezi, i cili kryesisht ishte në vitet 25-40 të jetës së stuhishme krijuese, letrare e patriotike, si Parashqevi Qiriazi dhe Mit'hat Frashëri, 28-vjeç, Luigj Gurakuqi, 29-vjeç, Mihal Grameno, 36 vjeç, Gjergj Fishta dhe Sevasti Qiriazi, 37 vjeç, e kështu me radhë...

Se ishte kongresi që caktoi fatin dhe rreshtimin gjithëshqiptar e dëshmon edhe fakti se qe reprezent i të gjitha trojeve, thënë troç: një bashkim i vërtetë kombëtar, duke pasur delegatë edhe nga Kosova, Rrok Berisha i Gjakovës, Hafëz Ibrahim Efendiu, Emin Beu dhe Selahedin Beu të Prizrenit, por të sofistikuar si përfaqësues qoftë nga vendi ku ishin me shërbim, qoftë ngaqë duhej të përplotsohej prania e të katër vilajeteve: i Shkodrës,



i Kosovës, i Manastirit, i Janinës.

Duke u ndërlidhur me këtë përvjetor të rëndësishëm, nga më të rëndësishmit, nuk mund të mos kujtojmë me pietet kontributin e dy zonjave të nderuara, dy motrave që bënë të pamundurën për kohën kur u formuan dhe vepruan që të ndryshonte historia! Formimi i tyre intelektual e me primesa të jashtëzakonshme atdhetdashurie nuk ishte as i rastësishëm, as i imponuar. Në Manastirin e gjysmës së dytë të shekullit XIX, fillimisht Sevastia (e lindur më 1871), por pas pak vitesh edhe Parashqevina (e lindur më 1880) do të rriteshin e formoheshin mu në zemër të Perandorisë Turke me një kulturë perëndimore, duke ndjekur shkollën e kolegje amerikane. Mësimet e para, qe një ogur i bardhë ky, do t'i ndiqnin pikërisht në Manastir, por që patën fatin të ndjekin më pastaj edhe kolegjin amerikan në Stamboll për t'u pajisur jo vetëm me diploma e certifikata të nevojshme për të zhvilluar aktivitetin iluminist e arsimor në Korçë e Manastir, por në rrethana të tjera edhe në Tiranën mbretërore të viteve 20 dhe 30 të shekullit XX.

Prania anglo-amerikane në Manastirin e gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe përfaqimi i ideve, frymës dhe kulturës perëndimore, e parimeve të shenjta të lirisë dhe të drejtave individuale e shoqërore me traditë shekullore demokratike ishte një moment vendimtar rreshtimi të Motrave Qiriazi dhe udhërrëfyes jetësor për veprimtarinë e tyre poliedrike.

Ato, edhe pse përballëshin me trynitë e një mentaliteti, të një sërë pengesash për të pamundësuar veprimtaritë e 'këndelljes' së popullit nga një pushtim i gjatë dhe ushtrim i përvetësimit të manireve dhe tipareve të një kulture aziatike fatale për popullin shqiptar, arritën të hapin shkollën e vashave më 23 tetor 1891 në Korçë. E guximshme, e përgjegjshme, e tejkohshme për kohën dhe rrethanat, por jo e pamundur për idealin e tyre. Shkollën e vashave si refleksi imediat i emancipimit dhe arsimimit të pjesës më të ndeshme të një populli, e pjesës që do të përcaktojë fatin e zhvillimeve dhe të ardhmes, një të ardhmeje krejt ndryshe nga ç'përjetuan nëna e etër brez pas brezi, duke e vënë në pikëpyetje atë që fqinjët tashmë e kishin arritur,

përfaqësimin e denjë të gruas në të gjitha porët e jetës.

Në këtë rrugëtim fqinjët kishin shkuar edhe më larg, kishin futur edhe aspirata lakmëtare, duke shfrytëzuar fatkeqësinë e tjetrit, robërinë e tjetrit, për ta pasur sa më të lehtë marshimin mbi përpelitet e tjetrit. Motrat Qiriazi, të vetëdijshme për rolin e gruas në shoqëri, iu përvëshën një pune në rrethana pothuajse të pamundura për veprim dhe me mungesën e tmerrshme të një alfabeti në sajimin e teksteve që do të kishin shtrirje më të madhe territoriale e hapësinore.

Orientimi i tyre që në hapat e parë, drejt njohjes së realiteteve aspak të favorshme për veprim, hasi udhërrëfyesin e besueshëm, yllin polar në errësirën anadollake e kleptomani në e fqinjësisë për t'u orientuar drejt perëndimit, drejt kulturës dhe demokracisë së vënë tashmë në veprim me rezultate kolosale. Ajo duhej aplikuar, duhej vënë në veprim sa më parë tek shqiptarët, për të mos i lënë vend dilemave për një alfabet grek apo arab, një alfabeti konglomerat, por të një alfabeti që do të çonte drejt një uniteti të përgjithshëm kombëtar e kulturor.

Nga ç'thonë të gjitha burimet e kohës, shqiptare e të huaja, promotore të Kongresit të Alfabetit pa dyshim që ishin vetë Motrat Qiriazi. Ato i dhanë shtysën dhe ngritën moralin e burërisë, edhe pse iu qe pamundësuar ndjekja e drejtpërdrejtë e seancave dhe zhvillimeve në ambientet e Kongresit. Shtëpia e tyre në Manastir, për fat shumë afër me shtëpinë tashmë monument të Kongresit të Alfabetit, do të qe e hapur ditërat për takimet e çdoditshëm të Komisionit të Kongresit dhe diskutimet sa ishin të zjarrta, herë-herë edhe pafundkrye, që së fundi do t'ia dilnin mbanë përgjegjësisë historike. Në të vërtetë, Sevastia do të qe e detyruar të përkujdesej për shkollën e vashave në Korçë, e cila falë reformave të çastit kishte një fluks të shtuar të të interesuarave për ta vijuar atë, por Parashqevina nuk iu tremb as pasigurisë së udhëtimit, as kurtheve nga më të ndryshmet, as padrejtësisë gjinore të pushtetit aziatik, por u bë shembull e bashkëveprimit, konstruktivitetit, arsyeshmërisë së ideve dhe arritjen

e unitetit të përgjithshëm.

Sepse Kongresi do t'i jepte shtysën imediate ngjarjeve që do të pasonin, normales së Elbasanit, shpalljes së Pavarësisë, hartimit dhe shtypjes së teksteve shkollore, nga nivelet më të ulëta e deri tek institutet që nuk do të mungojnë të hapen në vijimësi. Motrat Qiriazi, në unison ndërveprimesh do të shkëmbejnë përvoja, duke kaluar edhe Atlantikun, duke krijuar miqësi të cilat do të reflektojnë edhe në Konferencën e Paqes, ku Parashqevina qe një veçanti edhe për vendet më të qytetëruara të pranisë së një gruaje në delegacione të nivelit shtetëror e kombëtar.

Instituti Qiriazi, fillimisht i hapur në Korçë, dhe më vonë me konsolidimin shtetëror edhe në Tiranë, me premisat e një instituti si në vendet me traditë të gjatë dhe të suksesshme në fushën e edukimit institucional, s' do të vonojë dhe do t'iu 'merrej' padrejtësisht duke u shndërruar në Institutin "Nëna Mbretëreshë", por kjo ishte një asgjë, në krahasim me kalvarin që do ta përjetojnë me ardhjen në pushtet të komunizmit. Ato përfundimisht do t'i mbulojë pluhuri i harresës, dhe, si çdo shenjteri e kësobotshme, do të rilinden pikërisht në 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit!

Sevastia, e ndarë nga kjo botë më 1949, me të motrën Parashqevinë që jetoi si jetoi deri më 1970, janë engjëjt e shkronjave shqipe, janë shenjtëreshat e arsimimit dhe të emancipimit shqiptar, janë emblema e formimit dhe zhvillimit të shtetësisë shqiptare, edhe pse ajo shtetësi, në foshnjërinë dhe 'pjekurinë' e vet ishte aq e pamëshirshme me figurën dhe personalitetin e pakontestueshëm të tyre!

Pikërisht në 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit, ato rilinden dhe dalin me aureolën e shkronjave të arta shqipe, me përkatësinë tashmë të pranuar botërisht të shqiptarëve në familjen evropiane.

Manastiri i Motrave Qiriazi si kurrë më parë do të rikujtojë me pietet, për pak ditë që kanë mbetur deri tek ky përvjetor i rrallë dhe i jashtëzakonshëm, idealin e tyre, ëndrën e tyre, sakrificën e tyre, 'dënimin' e pamerituar të harresës, e cila tashmë është pjesë e arkivave dhe e turpit komunist.

Për 28 vjet rresht, sa veproji Shoqata për Emancipimin e Gruas "Motrat Qiriazi", me seli në Prishtinë dhe degët e saj në shumë pjesë të Kosovës, por, për coincidençë, edhe në Nju-Jork të Amerikës, kujtoj se ia ka dalë mbanë të rikthejë dinjitetshëm figurën e ndritshme të këtyre dy motrave, nismëtareve të shumë zhvillimeve me interes gjithëkombëtar.

110-vjetori i Kongresit të Manastirit dhe Alfabeti që kemi ne sot është meritë edhe e motrave Qiriazi!

**E rrallë**

## Brenda hotelit luksoz ku mund të flini me peshqit

Vizitorët e ishullit Conrad Maldives Rangali kanë mundësinë të "flenë" me peshqit për shkak se në vendpushim është hapur vila e parë nënujore. Imazhet përrallore tregojnë se si është një nga dhomat më të preferuara të hoteleve në botë. Vetëm një natë në hotelin nënujor kushton 50 000 dollarë.



**FOTO E DITES**



Një pamje ajrore e anijeve në Liqenin Marmara, ku nivelet e ujit kanë rënë pas temperaturave të larta gjatë verës. / AA/

**E jashtëzakonshme**

## Gjenden mbi 1 000 dhëmbë njeriu brenda një muri

Punëtorët e ndërtimit në Gjeorgji kanë pasur një surprizë 'drithëruese' për Halloween pasi zbuluan mbi 1 000 dhëmbë të varrosur brenda një muri. Një hapësirë tregtare e njohur si ndërtesa TB Converse në Valdosta po rinovohej kur punëtorët bënë zbulimin e frikshëm të martën. Dhëmbët ishin varrosur në një mur në



katin e dytë. Fotografitë që u bënë virale tregojnë dhëmbët të shpërndarë në mesin e suvasë. Është mister fakti se si dhëmbët përfunduan në mur, edhe pse hapësira më parë është përdorur nga dy dentistë të ndryshëm.

## BARSOLETA E DITËS



**Shoqet:**

- Po ta dëgjoja nënën, 100 herë më mirë më kishte rënë.
- E çfarë të thoshte nëna juaj?
- Jo, s'e di, se kurrë nuk e kam dëgjuar.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### “ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### “JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.

Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

#### “NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.

Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

#### “SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.

Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

#### “VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Sot do të jetë një ditë që do t'ju kujtojë diçka të dhimbshme. Megjithatë, do të dini ta rimerrni autokontrollin nga kujtimet.</p>	 <p><b>DEMI</b> Keni vullnet dhe do të bëni shumë përpara në një projekt të rëndësishëm. Me dëshirën e mirë për të ndihmuar, sot do të jeni pranë dikujt.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Sot do të ketë pak tension në jetën në çift, por kjo gjë nuk do të ndikojë në ndjenjat që keni për njëri-tjetrin.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Të gjithë do të kenë nevojë për ndihmën tuaj sot. Vendosmëria që ju karakterizon ju bën shumë të veçantë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot bëni mirë të mos flisni me këdo lidhur me një çështje delikate tuajën. Shumë fjalë do të keqpërdoren në të ardhmen.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Megjithëse për momentin financa tuaja nuk janë aq mirë sa ju mendoni, do të keni shpenzime që kanë lidhje me shtëpinë dhe familjen.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Sot jeni të dashuruar me natyrën, me qetësinë dhe me çdo gjë të bukur. Një piknik me njerëzit e afërt është ideali për ju.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Çështjet e xhelozisë dhe mënyra juaj posesive do ta prishin disi marrëdhënien në çift. Bëni mirë të tërhiqeni.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Kjo po që është një ditë shumë e bukur. Çdo gjë është në harmoni dhe ju ndiheni mjaft mirë që në orët e para të mëngjesit.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Megjithëse është një rrugë e gjatë për të arritur atë që keni planifikuar, e rëndësishme është që rezultati final do të jetë pozitiv.</p>	 <p><b>UJORI</b> Edhe pse dukeni njerëz të ftohtë, me ndjenjat do të zbuloni që jeni adoleshent dhe prekeni edhe për gjërat më të vogla.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Humori ditën e sotme nuk është në nivele të kënaqshme. Megjithatë, partneri do të përpiqet t'ju tregojë se është pranë jush.</p>

## Fero thotë se nuk do të bashkëpunojë kurrë me Getinjon



Një nga reperët më të diskutuar ishte i ftuar në programin "Shiko kush luan" të Luana Vjollcës. Fero, i njohur tashmë edhe për diss-et dhe fjalorin paksa të ashpër që përdor në tekstet e veta, nuk ngurroi të bënte një sfidë e cila e vinte përballë reperëve të njohur shqiptarë. I pajisur me një pushkë


"paint ball" ai duhet t'i qëllonte fotografitë e tyre pasi të dëgjonte pyetjet drejtuar nga Adi Pojana. Gjatë kësaj sfide Fero zbuloi inatet me dy vëllezërit që janë larguar nga "On Records", Getinjo dhe Mozzik. I pyetur se cili është reperi që nuk do të bashkëpunojë kurrë, ai zgjodhi Getinjon si përgjigje.

## Fondacioni Shakira do të ndërtojë dy shkolla në Kolumbi



Shakira ka hedhur themelet e dy shkollave në Kolumbi, në vendlindjen e vet. Këngëtarja dhe filantropja e famshme ka vizituar javën që lamë pas qytetin historik të Cartagenas dhe vendosi gurëthemelet e para në një shkollë që do të shërbejë për 1 000 fëmijë.

Pastaj edhe në qytetin e Barranquillas ajo inauguroi ndërtimin e një strukture të ngjashme për dhjetëra nxënës të tjerë. Ndërtimi i shkollave do të financohet nga Pies Descalzos, një fondacion i drejtuar nga Shakira, që aktualisht menaxhon tri shkolla për fëmijët pa përkrahje.




## Dua Lipa rrëmben tri çmime të mëdha

Ajo është këngëtarja më e suksesshme e muzikës pop dhe po kthen në hit çdo projekt të ri muzikor. Dua Lipa mori pjesë në galanë e 'Los 40 Music Awards' në Madrid të Spanjës ku arriti t'i rrëmbejë tri çmime. Nëpërmjet

një postimi në "Instagram" ajo shfaqej shumë e lumtur për këtë arritje. Këngëtarja me origjinë shqiptare zgjodhi që të prezantohej me një fustan të shkurtër plot me ngjyra, që i nxirrte në pah linjat e mira trupore.

## Justin Bieber i dedikon një tatuazh gruas



Trupi i tij është i mbuluar me tatuazhe, prandaj nuk kishte si t'i mungonte një kushtuar gruas. Justin Bieber ka bërë një të tillë në fytyrë,

mbi vetull, për Hailey Baldwin. Çifti u martuan në mënyrë të fshehtë në shtator dhe, sipas burimeve, të dy kanë tatuazhe kushtuar njëri-tjetrit.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

HUDDERSFIELD - FULHAM

1

ESPANYOL - ATHLETIC BILBAO

GG3+

OSNABRUCK - UERDINGEN

1

# Java e mysafirëve

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 4 NËNTOR** - Prej gjashtë ndeshjeve të zhvilluara në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pesë prej tyre i kanë fituar skuadrat mysafire. Fitorja që vlerësohet si më e madhja ishte e Lirisë në përballje me kampionen aktuale, Dritën. Fitores të dielën i është gëzuar edhe Llapi ndaj Ferizajt, kurse e vetmja ndeshje që përfundoi baras në këtë xhiro ishte në mes të Trepçës '89 dhe Gjilanit. Të shtunën fitore shënuan Feronikeli, Prishtina dhe Flamurtari.



shi që ditë më parë mbeti pa trajnerin Gugash Magani, arriti ta barazojë rezultatin në pjesën e dytë, me golin e shënuar nga talenti Arb Manaj në minutën e 76. Pas kësaj xhiroje Trepça '89 pozicionohet e nënta me 16 pikë. Ndërsa Gjilani zë pozitën e gjashtë me 21 pikë.

## Drita - Liria 0-1

Fitoren më të rëndësishme në kuadër të xhiros së katërmbëdhjetë në elitë e ka regjistruar Liria, e cila në Gjilan i ka mposhtur kampionët e Dritës (0-1). Vendësit patën më shumë nga loja, por ishte skuadra mysafire që shënoi golin e fitores nëpërmjet sulmuesit Fatih Karahoda, katër minuta para fundit të ndeshjes. Në këtë mënyrë skuadra e Dritës duhet të pajtohet me humbje pas disa rezultateve të mira në xhirot e fundit në Superligë.

## Ferizaj - Llapi 0-1

Llapi e ka rritur diferencën e pikëve me skuadrën e Dritës, pasi të dielën e ka mposhtur Ferizajin (0-1). Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0, kurse mysafirët e drejtuar nga Bekim Shotani arritën fitoren tetë minuta pa përfunduar ndeshja. Golashënues ishte sulmuesi Shend Kelmendi i cili realizoi për 0-1. Llapi zë vendin e tretë me 26 pikë, kurse Ferizaj është i parafundit me vetëm 11 pikë të grumbulluara.

## Trepça '89 - Gjilani 1-1

Ndeshja e tretë e zhvilluar të dielën në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë në mes të Trepçës '89 dhe Gjilanit përfundoi me rezultat 1-1. Kjo ishte ndeshja e vetme që përfundoi baras në kuadër të xhiros së katërmbëdhjetë në IPKO Superligë. Golin e parë në ndeshje e realizuan mysafirët në minutën e 25-të. Autor i golit ishte Vilfor Hysa. 89-

## Ballkani - Feronikeli 0-1

Feronikeli ka marrë tri pikë të reja nga ndeshja kundër Ballkanit në Suharekë, pasi ka shënuar fitore me rezultat minimal 0-1. Skuadra nga Drenasi pas kësaj fitore vazhdon të jetë lidere në tabelën e klasifikimit në IPKO Superligë. Golin e vetëm në këtë ndeshje e ka realizuar Kastriot Rexha në minutën e 26. Pas kësaj xhiroje Feronikeli vazhdon të jetë në krye të renditjes me dy pikë me shumë se Prishtina. Ballkani mbetet në kuotën e 18 pikë.

## Drenica - Prishtina 0-1

Fitore me rezultat sikurse "Nikli" ka shënuar edhe Prishtina, e cila e ka mposhtur Drenicën në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj (0-1). Vendësit kishin shumë raste shënimi, por assesit nuk arritën të shënojnë gol, kurse në anën tjetër skuadra mysafire dështoi në disa raste që kishite, por një minutë para fundit realizoi golin e fitores. Basit Khalid e mposhti portierin vendës pas një goditje të saktë me kokë. Prishtina vazhdon të jetë përcjellësja e parë e Feronikelit dhe, sipas rezultateve, deri tash këto dy ekipe pritet të luftojnë për titull deri në fund.

## KEK-u - Flamurtari 3-4

Fitoren e tretë të shtunën e realizoi si mysafir Flamurtari i Prishtinës.

Kuqezinjët e mposhtën KEK-un me rezultat 3-4. Pas gjashtë minutave lojë, Rilind Nimani i kaloi vendësit në epërsi 1-0, kurse dy minuta më vonë rezultatin e barazoi sulmuesi më efikas në elitë, Alban Shillova, i cili realizoi për 1-1. Në minutën e 27 Agron Bruqi me një goditje me kokë i kaloi mysafirët në epërsi 1-2, derisa pas gjysmë ore lojë Vigan Veliu i barazoi shifrat në 2-2. Egzon Krasniqi në pjesën e dytë realizoi dy gola të tjerë për Flamurtarin, kurse për vendësit golin e fundit në ndeshje e realizoi Gëzim Berisha.

IPKO SUPERLIGA		
Drita - Liria		0-1
Ferizaj - Llapi		0-1
Trepça '89 - Gjilani		1-1
Ballkani - Feronikeli		0-1
Drenica - Prishtina		0-1
KEK-u - Flamurtari		3-4
TABELA		
1. Feronikeli	13	32 pikë
2. Prishtina	13	30
3. Llapi	14	26
4. Drita	14	22
5. Flamurtari	14	22
6. Gjilani	14	21
7. Drenica	14	18
8. Ballkani	14	18
9. Trepça '89	13	16
10. Liria	13	13
11. Ferizaj	12	11
12. KEK-u	13	1
LIGA E PARË		
Fushë Kosova - 2 Korriku		0-0
Drenasi - Vushtrria		1-3
Dukagjini - Bashkimi (K)		5-0
Ramiz Sadiku - Istogu		2-4
Onix - Besa		0-2
Vëllaznimi - Trepça		1-1
Arbëria - Vitia		0-1
Kika - Vllaznia		2-1
TABELA		
1. Besa	12	27 pikë
2. Vushtrria	12	26
3. Dukagjini	12	24
4. Vvllaznimi	12	23
5. Vitia	12	21
6. Onix	12	19
7. Arbëria	12	18
8. Istogu	12	17
9. Trepça	12	17
10. Kika	12	13
11. Drenasi	12	12
12. FushëKosova	12	12
13. Ramiz Sadiku	12	12
14. 2 Korriku	12	11
15. Bashkimi (K)	12	9
16. Vllaznia	12	7

## SHKURT

### Besa e fitoi derbin ndaj Dritës në hendboll

Rreth 700 shikues e kanë përcjellë ndeshjen më interesante të javës së gjashtë të Superligës së Kosovës në hendboll. Në Gjilan u takuan Drita dhe kampionia aktuale, Besa Famgas. Të dy skuadrat i kishin fituar pesë ndeshjet e para. Serinë e fitoreve e vazhdoi Besa që triumfoi ndaj Dritës me rezultat 35:22. Tani vetëm Kastrioti e Besa kanë pikë maksimale, nga 12. Prishtina e Drita mbajnë vendet tre e katër me nga 10 pikë. Të shtunën u luajtën edhe dy ndeshje të tjera të javës së gjashtë. Prishtina fitoi ndaj Zhegrës me rezultat 48:29, kurse Trepça e mposhti Drenicën me rezultat 28:21.

### Istogu "detyron" Dragushën të japë dorëheqje

Skuadra e Istogut e ka mposhtur Ramiz Sadikun me rezultat 4-2, kurse pas kësaj humbje ka dhënë dorëheqje trajneri Alban Dragusha. Ky i fundit në verë ishte pensionuar nga futbollit aktiv dhe vendosi të merret me zejen e trajnerit. Ai mori drejtimin e skuadrës së Ramiz Sadikut nga Prishtina por, pas rezultateve jo të mira dhe humbjes së fundit nga Istogu, ka vendosur të japë dorëheqje.

### Zeneli realizon gol, Heerenveeni ndahet baras

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, ka realizuar një gol të jashtëzakonshëm ndaj Emmenit në xhiron e 11-të të Eredivisies holandeze. Zeneli realizoi golin e epërsisë për Heerenveenin në minutën e 30 nga një gjuajtje dënimi, kurse mysafirët e barazuan rezultatin dy minuta para fundit të ndeshjes me anë të Reuven Niemeijerit.

### Trepça e mposhti Bashkimin, Rahoveci shumë i fortë për Lipjanin

Trepça ka regjistruar fitore prej 88-84 kundër Bashkimit në ndeshjen e xhiros së shtatë të Superligës së Kosovës në basketboll që u zhvillua në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren. Vendësit e nisën më mirë takimin duke i shënuar pesë pikë më shumë se ekipi kundërshtar (27:22). Në fraksionin e dytë, 'Minatorët' shënuan një pikë më shumë se nikoqirët (25:26), ashtu që me katër pikë avantazh për prizrenasit (52-48) skuadrat shkuan në pushim. Mysafirët bënë paraqitje më të mirë në çerekun e tretë (15:19) duke arritur ta barazojnë rezultatin. Ekipi mitrovicas ia doli ta fitonte dhjetëminutëshin e katërt (17:21) dhe në këtë mënyrë e fitoi edhe ndeshjen në përgjithësi. Ndërsa Rahoveci ka shënuar fitore bindëse kundër Lipjanit me rezultat 88-66.

## Shaqiri kërkon respekt: Jam fitues i Ligës së Kampionëve

**LIVERPOOL, 4 MARS** - Xherdan Shaqiri i ka goditur kritikët, duke ua kujtuar se ai është fitues i shumë trofeve, përfshirë Ligën e Kampionëve me Bayern Munchenin, si dhe ka insistuar se duhet të mbahet në mend

për sukseset dhe jo për rënien nga Premierliga me Stoke Cityn sezonin e kaluar. Shaqiri ka reaguar ashpër ndaj sugjerimeve se Jurgen Kloppi e ka transferuar atë për ta plotësuar numrin e lojtarëve në

Liverpool. "Rënia nga liga me Stoken ishte përvojë shumë e keqe për klubin dhe mua dhe shpresoj se klubi do të rikthehet në Premierligë. Por, përkundër asaj që ndodhi atje, unë jam fitues i Ligës së Kampionëve.

Mendoj se kjo meriton respekt", ka thënë Shaqiri. "Njerëzit duhet ta mbajnë në mend se ku kam luajtur më parë, cilësitë që i kam, si dhe atë që e kam arritur në futboll. Kam luajtur për njërin prej klubeve

më të mëdha në botë, Bayern Munchen, dhe përsëri po luaj për një klub shumë të madh, prandaj nuk ndiej presion në fanellën e Liverpoolit", ka shtuar Shaqiri, i cili ka luajtur edhe për Interin.



## Greza: Rendësi kanë tri pikët

GLASGOU, 4 NËNTOR - Eros Greza e ka fituar një vend titullari te skuadra e famshme scoceze, Rangers. Sulmuesi shqiptar luajti nga fillimi në ndeshjen që Rangersi e fitoi në

udhëtim te St Mirren (0-2). Edhe pse nuk ishte ndonjë paraqitje e madhe nga Greza, gjakovari ka thënë se është argëtuar në fushë. "Jam argëtuar shumë duke luajtur me

skuadrën që nga fillimi, por ishte pak e vështirë për shkak të kushteve atmosferike, shi dhe erë e fortë. Gjëja më e rëndësishme në fund është që morëm tri pikët dhe fitoren që

na duhej. Mendoj se kemi bërë mirë, sidomos pas një pjese të parë të vështirë, ku kushtet atmosferike i kishim kundër. Në pjesën e dytë ne luajtëm futboll të mirë", ka thënë Greza.



# Loriana dhe Akili, të artë në Hungari

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Sukseset nga sporti i xhudos në arenën ndërkombëtare nuk kanë të ndalur, pasi në fundjavë xhuditja Loriana Kuka dhe xhudisti Akil Gjakova janë shpallur kampione në Evropianin që po bahet në Gyor të Hungarisë. Xhudistja Kuka është shpallur kampione e Evropës U23, pas triumfit në finale ndaj gjermanes Christina Faber. Pas triumfit të Lorianës, trajneri Driton Kuka ka thënë se kjo medalje është e veçantë për familjen Kuka për faktin se është e para nga një kampionat. "E veçantë kjo medalje për mua, për familjen Kuka, për vëllanë tim Sylën që e kam pasur trajner dhe udhërrëfyes në jetë! Loriana la Zvicrën për Kosovën, erdhi para dy vjetësh dhe u vendos në Pejë për ta tritur performancën, por edhe për ta përfaqësuar vendin e familjes së saj. Medalja e parë nga një Kampionat Evropian për dikë nga familja jonë. Shumë i lumtur për këtë



medalje!", ka shkruar Kuka në "Facebook". Ashtu sikurse Loriana Kuka, edhe Akil Gjakova është shpallur kampion në Kampionatin Evropian U-23. Xhudisti shqiptar vazhdoi formën e mirë të shfaqur këtë vit, duke u shpallur kampion i evropianit që po mbahet në Gyor të Hungarisë. Gjakova në finalen e kategorisë deri në 73 kilogramë mposhti me Ippon Rufat Mamadov të Azerbajxhanit. Paraprakisht,

Akili kishte shënuar edhe katër fitore të tjera, ndërsa raundin e parë e kaloi pa luftë. Në raundin e dytë mundi serbin Filip Jovanović, të tretin mposhti holandezin Roy Schipper, kurse në çerekfinale italianin Gabriele Sulli. Fitore maestrale me Ippon shënoi në gjysmëfinale ndaj Marcel Cercea të Rumanisë. Ndërsa Shpati Zekaj shënoi një fitore dhe një humbje në kategorinë -90 kg, kurse Andi Artani u mund në raundin e parë.

# LeBroni shpëton lakersat nga humbja

PORTLAND, 4 NËNTOR - Vijon kriza e skuadrës së Clevelandit që, edhe pse e shkarkoi trajnerin, sërisht nuk arrin të fitojë. Cavaliersi u mund 126-94 nga Charlotte, ndeshje e dominuar nga kjo e fundit, që e thelloi epërsinë nga perioda në periodë. 67 pikë për Charlotten u realizuan nga lojtarët e stolit, çfarë tregon për një lojë të mirë kolektive, ndërsa te Clevelandi ndihet mungesa e një lideri si dhe ajo e Kevin Love, i dëmtuar. Indiana triumfon në sekondat e fundit 102-101 ndaj Bostonit në një përballje me shumë rivalitet dhe emocione, e hapur deri në fund. Oladipo me 24 pikë e 12 rebaunde ishte vendimtar për Indianën, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e Morrisit për Celticsin. Fitorja e dytë radhazi për Lakersat, që mundën 114-110 Portlandin në shtëpinë e këtij të fundit. Kalifornianët dominuan në ndeshje, por në fund rezikuan ta humbnin atë. Më i mirë për lakersat ishte LeBron James me 28 pikë, mbështetur edhe nga Rondo me 17 pikë e 10 rebaunde për Portlandin u dalluan Lillardit e McCollumi me nga 30 pikë secili, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Skuadra surprizë në



Perëndim mbetet ajo e Denverit, që e mundi 103-88 Utah Jazzin dhe qëndron si forca e dytë, pas Golden State. Për Denverin u dalluan Harrisit me 20 pikë dhe Morrisit me 19, një dyshe që po bën diferencën në fushë në çdo takim. Një moment të mirë po kalon edhe Houstoni, që

triumfoi 96-88 ndaj Chicagos jashtë fushës, një ndeshje me rivalitet në pjesën e parë, ndërsa në të dytën erdhi shkëputja e Rocketsit. Hardeni me 25 pikë bëri diferencën në fushë për miqtë, ndërsa 21 pikët e LaVine mbetën për statistikë. Fiton edhe Atlanta, që mundi 123-118 Miamin, ndeshje me rivalitet e emocione, ku u dallua Youngu me 24 pikë e 15 rebaunde. Pa problem fiton edhe skuadra e San Antonios, që mposhti 109-96 New Orleansin, ndeshje e dominuar nga Spursi, me DeRozan që realizoi 26 pikë e Aldridge, që e mbylli me 22 pikë e 12 rebaunde.

### REZULTATET

Charlotte - Cleveland	126-94
Indiana - Boston	102-101
Atlanta - Miami	123-118
Chicago - Houston	88-96
San Antonio - New Orleans	109-95
Denver - Utah Jazz	103-88
Portland - Lakers	110-114

### SHKURT

## Marquezi fiton garën, Honda titullin në MotoGP

Mark Marquezi nuk ndalet në këtë sezon të Botërorit të MotoGP. Piloti spanjoll, edhe pse e ka siguruar tashmë titullin kampion për pilotë, triumfoi në Çmimin e Madh të Tajlandës, duke bërë të mundur edhe fitimin e kampionatit për konstruktorë nga ana e Hondës. Marquezi shfrytëzoi mjaft mirë momentin e rrëzimit të Valentino Rossit katër xhiro nga fundi i garës për të marrë këtë fitore të radhës në karrierën e tij që është e 70. Në vendin e dytë u rendit Aleks Rins me Suzukin e tij që në çastet e fundit ia rrëmbeu këtë vend francezit Johan Zarko që e nisi garën nga pole position për ta mbyllur atë në vendin e tretë i ndjekur nga Vinjales në vendin e katërt. Ducati zhgënjeu totalisht në Çmimin e Madh të Tajlandës me Dovizioso që nuk shkoi më shumë se vendi i 6, ndërkohë që Pirro u tërhoq përfundimisht.

## Krasniqi largohet nga Malajzia

